

من أسرار المنهج الرباني

تأليف

الأستاذ الدكتور محمد سعيد رمضان البوطي رحمه الله

Titulli i otigjinalit

Min Esrar el Menhexh el Rab-banijj

Prof.Dr.Said Ramadan el Buti

FSHEHTËSITË E DISA LIGJEVE KUR'ANORE

Prof. Dr. Muhamed Said Ramadan El Buti

Përktheu dhe përshtati nga arabishtja

Doc.Dr.Hfz. Hajredin Hoxha

2013

Recesent: Edin Lohja

Redaktore gjuhësore: Mimoza Sinani

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Parathënie

Falënderimi i qoftë Allahut xh.sh., ashtu siç i takon madhërisë së Tij. I lavdëruar je o Allah! Unë s'mund të të falënderoj Ty ashtu siç Ti e ke falënderuar Vetveten. Përgëzimet, përshëndetjet dhe lutjet më të sinqerta qofshin mbi Muhamedin a.s., familjen e tij dhe shokët e tij!

Është ky fillimi i ciklit të ligjëratave të shkurtra, të përgatitura për “*Radio Kuvajtin*” i titulluar: “**Ligj dhe Urtësi** “ **حُكْمٌ وَحِكْمَةٌ**”

Pikësynimi i ligjëratave në fjalë ishte përmendja e disa ligjeve, të karakterit fetar (të shariatit), të argumentuara nga Kur’ani dhe Sunneti, duke dëftuar më pas urtësitë e këtyre ligjeve. Kisha planifikuar që këto ligjërata, me të njëjtin titull, t’i botoj ashtu siç qenë të përgatitura për “*Radio Kuvajtin*”. Ndërkohë një shtëpi botuese shprehu dëshirën e saj që këto ligjërata të botohen, mirëpo me një titull tjetër për shkak se titulli paraprak nuk ishte i përshtatshëm. Prandaj, duke i përfillur kërkesat e disa lexuesve të nderuar, e pashë të arsyeshme ta ndërroj titullin paraprak me një titull tjetër “**Fshehtësitë e ligjeve hyjnore**” **من أسرار المنهج الرباني**

Jam përpjekur që këto ligjërata të jenë të qarta, në mënyrë që të kenë efektin e tyre. Pa dyshim se libri në fjalë mund të konsiderohet si përgjigje për të gjithë ata që duan të dinë arsyen, urtësinë dhe dobitë e çdo ligji kur’anor. I lutem Allahut që të jetë i kënaqur me ne, të na ruajë nga epshet tona dhe të na sigurojë të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër, sepse njëmend Ai është i plotfuqishëm mbi çdo gjë.

Dr. Muhamed Said Ramadan El-Buti

1- BESIMI NË ALLAHUN XH.SH. DHE URTIA E DOMOSDOSHMERISË SË TIJ

Allahu xh.sh. në Kur'anin famëlartë thotë:

“O ju njerëz! Me të vërtetë, juve ju ka ardhur i Dërguari (Muhammedi a.s.) me të vërtetën nga Zoti juaj, kështu që besojeni atë; kjo është më mirë për ju. Por nëse ju nuk besoni, atëherë të Allahut janë gjithë çka në qiej dhe në tokë dhe Allahu është kurdoherë i Gjithëditur, më i Urti, Gjithëgjykuesi”. [Suretu En-Nisa'-170.]

Ky ajet kur'anor përmban vendimin më obligativ, me të cilin Allahu xh.sh. u është drejtuar mbarë njerëzisë në vende dhe kohëra të ndryshme, e ky vendim është besimi tek një Allah; besimi se Ai është i vetmi krijues, se Ai është i vetmi që bën mirë (dhe keq), se Ai është shkaktari i ekzistencës. Është Ai që i ka krijuar gjërat në natyrën e tyre të posaçme dhe ua ka caktuar detyrat dhe obligimet e tyre, d.m.th. është Ai i cili ia ka dhënë çdo gjëje formën e vet e pastaj e ka udhëzuar atë. Është Ai i cili ka për t'i mbledhur të gjithë njerëzit në një ditë për të cilën nuk ka dyshim (*ditën e kiametit sh.p.*), një grup do të jetë në xhenet, e një tjetër në zjarr. Nga ky obligim (besimi në Allahun xh.sh.) nuk përjashtohet askush tjetër përpos fëmijët e vegjël, ata që janë të marrë (të çmendur), ose ata që kanë jetuar në një ambient ku nuk kanë pasur rastin të dëgjojnë emrin e fesë, ose ndonjë qortues apo udhëzues. Për këta, dhe të tjerët që janë të ngjashëm me ta, iu përshtatet fjala e Allahut xh.sh.: *“Ne nuk e dënojmë një popull pa i dërguar atyre të dërguar (pejgamberë)”*. [*El Isra:15*]

Shumica pyesin: ku është mençuria (ku qëndron fshehtësia) e këtij obligimi nga Allahu xh.sh.? Ndërsa disa të tjerë pyesin: çfarë dobie ka Allahu xh.sh. nëse robërit e Tij i nënshtrohen me besim dhe çfarë të keqe ka Allahu xh.sh. nëse ata (robërit) nuk i nënshtrohen Atij?

Nëse ne çuditemi dhe pyesim për llojin e dobisë dhe të dëmit atëherë përgjigjja është se dobia e besimit tek Allahu xh.sh. dhe e nënshtimit ndaj Atij nuk i kthehet Allahut xh.sh. Realiteti është, se dobia e besimit në Allahun xh.sh. dhe dëmi nga mosbesimi i kthehet shoqërisë njerëzore. Sqarimi i këtij problemi është se njeriu është i krijuar dhe i përbërë nga një sërë cilësish, në mënyrë që atij t'i mundësohet rindërtimi dhe përpunimi i tokës me qëllim që të përfitojë nga nënshtimi i saj, si p.sh. cilësia e logjikës, e të menduarit, egoizmi, forca dhe pasojat që rrjedhin

nga ajo, si dëshira për pozitë dhe karrierë. Të gjitha këto (elemente) nuk mund ta kryejnë rolin e tyre pozitiv në dobi të shoqërisë njerëzore nëse mbi to nuk mbizotëron një kujdestari (mbikëqyrje) e lartë dhe nëse personi që i zotëron këto cilësi nuk e ndien këtë mbikëqyrje. Sepse këto veti njerëzore, nëse lihen kështu të lira e pa mbikëqyrje, në vend se të jenë burime të hairit dhe rehatisë, shndërrohen në burime negative. P.sh. logjika dhe të menduarit (pa këtë mbikëqyrje) kishin për t'u shndërruar në një mjet që do ta dëmtonte nderin e njeriut dhe ta rrezikonte jetën e tij. Fuqia dhe forca e madhe (pa këtë mbikëqyrje) kishin për t'u shndërruar në një furtunë të pamëshirshme e cila kishte për ta përfshirë shoqërinë njerëzore dhe, si pasojë e kësaj, do të ekzistonte klasa e fortë aristokrate dhe shtresa e dobët e bujkrobërve. Barbarizmi njerëzor aktual është fryt apo rezultat i lirisë absolute të këtyre attributeve të lartpërmendura. Kur nuk ekziston mbikëqyrja dhe frika nga dënimi i veprave të këqija dhe të pamoralshme, natyra e këtyre cilësive funksionon negativisht, pa kontroll dhe frikë nga Allahu xh.sh.

Adhurimi (nënshtrimi) i njeriut nga të tjerët është fryt i lirisë absolute të këtyre cilësive; sepse kur këto attribute shfrenohen dhe çlirohen nga kujdestaria e lartë e Allahut xh.sh. atëherë kjo jetë shndërrohet në një arenë ku secili mundohet ta mundë dhe ta mposhtë kundërshtarin.

E këtu kuptohet shkaku i arsyes së besimit në Allahun xh.sh., pasi nëse ata mizorë do të kishin besuar në ekzistencën e Allahut xh.sh. dhe të pejgamberëve të Allahut xh. sh., padyshim se ata kishin për t'u ndalur nga shtypja (mizoria) e të tjerëve, dhe ata robër kishin për t'u liruar nga robëria e tyre. Ne kemi një shembull adekuat dhe shumë interesant në Kur'anin e madhëruar: shembullin e Faraonit dhe shtypjen e tij të pamëshirshme ndaj popullit beni israil. Faraoni i kishte shndërruar ata në robër të poshtëruar, nga frika e madhe prej tij dhe nga besimi i patundshëm për aftësinë e tij kinse hyjnore (këtë e deklaruan edhe magjistarët e tij kur dolën në garë me Musain a.s., të cilët thanë se me forcën e Faraonit ne do të ngadhënjemë mbi Musain a.s.)

Kur në zemrat e tyre u fut besimi në Allahun xh.sh. dhe kur ata u bindën se Ai është i vetmi që sjell dobi dhe (dëm) që ngjall dhe vdes, atëherë dobësia e tyre u shndërrua në forcë. Ata u çliruan nga robëria e rrejshme e tyre ndaj njeriut dhe filluan t'i bëjnë rezistencë Faraonit dhe kërcënimeve të tij me një guxim dhe krenari të madhe. Kjo është e shënuar edhe në Kur'anin famëlartë. Allahu xh.sh. thotë:

“Atëherë (kur shkopi i Musait i gëlltiti) magjistarët u hodhën në sexhde e thanë: Ne i besuam Zotit të Harunit e të Musait. Ai (Faraoni) tha: A i besuat atij para se t'u jap unë leje? Ai (Musai) është prijësi juaj i cili ua mësoi magjinë. Unë do t'ua pres duart e këmbët tërthorazi, e do t'ju var në trungjet e hurmave, e atëherë ju do ta kuptoni se cili prej nesh ka

dënim më të ashpër e më të vazhdueshëm. Ata thanë: Pasha Atë që na krijoi, nuk të japim përparësi ty ndaj argumenteve që na erdhën, e ti bëje atë që mendon ta bësh, dhe mund të zbatosh vetëm atë që i takon jetës së kësaj bote! Ne i besuam Zotit tonë, që Ai të na i falë gabimet tona dhe magjinë me të cilën ti na detyrove. Allahu është më i miri (në të shpërblyerit) dhe më i përjetshmi (në të dënuar).” [Taha, 70-73]

Pra, fshehtësia dhe shkakut i domosdoshmërisë së besimit në Allahun xh.sh. qëndron në faktin se kjo vepër konsiderohet si faktori kryesor për ta nxjerrë njerëzimin nga robërimi ndaj njëri-tjetrit dhe për t'i futur të gjithë në adhurimin dhe nënshtrimin (absolut) ndaj Allahut xh.sh. Nuk ekziston asnjë metodë (mënyrë) tjetër për t'i nxjerrë njerëzit nga robëria e njëri-tjetrit, vetëm se që të gjithë t'i nënshtrohen dhe t'i besojnë sinqerisht Allahut xh.sh.

2-MËNYRA E BASHKIMIT TË MUSLIMANËVE

Allahu xh.sh. në Kur'an famëlartë thotë:

“Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llahut, e mos u përçani! Përkujtoni nimetin e All-llahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër.” [Ali Imran:103]

Ky ajet madhështor i librit të Allahut xh.sh. vendos një prej ligjeve më kryesore të shoqërisë islame, në mënyrë që kjo shoqëri të jetë e bashkuar dhe e lidhur mes vete dhe ky ajet kur'anor ua mundëson rrugën më të përsosur për realizimin e këtij ligji. E ky ligj është që të gjithë besimtarët të kapen për Litarin e Allahut xh. sh. e Litari i Allahut është Kur'ani me dispozitat e veta (*sheriati*).

Në këtë rast, ne nuk do të mundohemi që ta sqarojmë mençurinë e bashkimit të muslimanëve, pasi është treguar dhe vërtetuar në histori dobia e vëllazërim-bashkimit të tyre kur ata të gjithë ishin të bashkuar dhe të vëllazëruar, dhe po ashtu është parë dëmi dhe pasojat e këqija kur muslimanët janë larguar nga ky Litar dhe janë copëtuar mes vete.

Mirëpo ku qëndron mençuria që kapja (bashkëngjitja) e të gjithëve ne për Litarin e Allahut xh.sh. të jetë ajo e një rruge që na bashkon (njëson)?

Mençuria qëndron në faktin se popujt nuk mund të bashkohen dhe të lidhen mes vete nëse ata nuk kanë pasur më herët një parim dhe një ide të përbashkët, sepse pa u mbledhur të gjithë në një qendër ne nuk mund të bashkohemi, dhe pa u siguruar gjallëria e zemrës ne nuk mund të presim funksionimin e gjymtyrëve.

Provo të bashkosh një grup njerëzish që nuk kanë një besim të përbashkët, por që kanë mendime të ndryshme. A kish për t'iu përgjigjur dikush thirrjes tënde? Normal që askush nuk kishte për t'iu përgjigjur. Po ashtu provo ta thërrasësh në besim një grup që nuk ka asnjë parim e asnjë bindje. Thirrjes tënde, po ashtu, nuk kishte për t'iu përgjigjur askush.

Në historinë tonë të pashtershme islame, ne kemi një shembull shumë aktual, shembullin e dy fiseve më të mëdha në Gadishullin Arabik: fisin EUS dhe HAZREXH. Mes këtyre dy fiseve kishte pasur luftë dhe armiqësi, qindra vite para ardhjes së Muhamedit a.s. Si pikë e parë, Muhamedi a.s. i thirri ata në besimin tek Allahu xh.sh. Kur besimi u fut në zemrat e tyre dhe ata të gjithë e shijuan ëmbëlsinë e tij, atëherë Muhamedi a.s. i bashkoi dhe i vëllazëroi ata të gjithë në emër të fesë islame.

Po qe se Muhamedi a.s. nuk do të kishte ndjekur këtë metodë për t'i bashkuar dhe vëllazëruar ata, padyshim se ai kishte për të dështuar në thirrjen dhe misionin e tij. Me fjalë të tjera, po të ishte munduar në radhë

të parë që t'i vëllazëronte dhe bashkonte ata, pa e mbjellë besimin në zemrat e tyre, askush nuk kishte për t'iu përgjigjur thirrjes së tij. Mirëpo ai nuk veproi kështu, për t'i dhënë shembull botës në përgjithësi (*sh.p. dhe shqiptarëve në veçanti*) se pa besim nuk ka bashkim dhe vëllazërim, dhe çdo bashkim dhe vëllazërim, pa bazën e besimit në Islam, është formalitet dhe dështim.

Shembulli tjetër qëndron në bashkimin dhe vëllazërimin e ensarëve dhe muhaxhirëve. Më së pari Muhamedi a.s. ua mbolli besimin në zemër, e pastaj ata u vëllazëruan, dhe duke u nisur nga ky *parim (definicion)* edhe jahuditë u larguan nga Medina përgjithmonë.

Prandaj, nëse kërkojmë që ta ngremë lart një ndërtesë gjigante prej vëllazërim-bashkimit, obligimi më primar është që kësaj ndërtesë t'i vëmë për bazë dhe gur themel besimin në Allahun xh.sh. dhe parimet islame. Nëse startohet kësisoj, ndërtesa vetvetiu ngrihet dhe forcohet, e nëse nuk vihet për bazë besimi në Allahun xh.sh. dhe praktikimi i parimeve islame, por vihen epshet, mendimet dhe ideologjitë e ndryshme të njerëzve, atëherë kjo ndërtesë nuk ngrihet lart kurrë, sepse bazamenti është i dobët dhe jo i sigurt.

Kjo dukuri shihet qartë edhe në këtë ajet kur'anor, ku Allahu xh.sh. thotë:

“Dhe vërtet, kjo (urdhurat e Allahut të përmendura në ajetet 151 dhe 152 në suretun En'Aam) është rruga Ime e drejtë, kështu që ndiqeni atë dhe mos ndiqni rrugë të tjera, pasi ato do t'ju largojnë nga Udha e Tij. Kështu ju ka urdhëruar Ai që të mund të bëheni Muttekinë (të përkushtuar në besimin e pastër islam).” Suretu El-En'ame-153.

Ndoshta ju mund të pyesni: nëse problemi qëndron këtu, atëherë çfarë dallimi ka ky parim (ligj) i Allahut xh.sh. nga parimet (ligjet) njerëzore, dhe çfarë përparësie ka ligji i Allahut xh.sh. në këtë rast?

Përgjigjja është se: nëse largohemi nga ligjet që Allahu xh.sh. ua ka obliguar njerëzve, atëherë ata, deshën apo nuk deshën, do të përqafojnë ligje të tjera. Këto ligje (parime) njerëzore, që konsiderohen supozime, do të vihen në shënjestër të kritikës dhe të diskutimit rreth pranimit të tyre. Çdo individ, i cili posedon logjikë të shëndoshë ose aftësi të madhe arsyetimi, ka të drejtë dhe mund t'i refuzojë pa kurrfarë problemi këto ligje (parime) njerëzore, për arsye se ai posedon aftësi më të lartë se vetë ligjdhënësi. Në këtë rast, këto parime njerëzore do të bëhen shkak dhe burim kryesor për kundërshtim dhe përçarje, në vend se të jenë shkak për mirëkuptim dhe bashkim.

Mu për këtë arsye, për njerëzit nuk përshtatet asnjë ligj (parim) tjetër, përveç atij që u ka caktuar atyre Allahu xh.sh., Krijuesi i botës, nëse dëshirojmë që gjendja aktuale në botë të stabilizohet dhe të rregullohet.

3- TË PËRMENDURIT E ALLAHUT XH.SH. DHE EFEKTI I SAJ NË JETËN E NJERIUT

Allahu xh.sh. në Kur'anin famlartë thotë:

“Ti përmende Zotin tënd në vete (heshtas), me respekt e me drojë, jo me shprehje të larta, (përmende) në mëngjes e në mbrëmje dhe mos u bëj prej atyre që nuk kanë kujdes.” [Suretu El-A'raf-205.]

Ky ajet kur'anor vendos një parim shumë të rëndësishëm në jetën e njeriut, pra fillohet me mbjelljen e këtij ligji në zemër si qendër kryesore, e mandej efekti i tij shpërndahet në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Përmendja e Allahut xh.sh. një startim edukativ shumë i rëndësishëm që Ai e vendos për robërit e Tij në sipërfaqen e tokës. Përmendja apo përkujtimi i Allahut xh.sh. nuk bazohet në një veprim formal të gjuhës së njeriut, duke thënë subhanallah, ose në zhurmën e tespive, e as në luhatjet majtas apo djathtas mbi tokë. Realiteti i dhikrit dhe domethënia e tij e vërtetë aplikohet në këtë mënyrë: njeriu duhet të meditojë dhe logjikojë me zemrën e tij për madhërinë e Allahut xh.sh., për mbikëqyrjen dhe diturinë e Tij për çdo gjë, duke menduar për llogarinë tonë para gjykatës supreme, para Allahut xh.sh. për çdo vepër dhe për çdo krim.

Kësi lloj ajetesh në Kur'anin e madhëruar janë të shumta. Mirëpo cila është mençuria që qëndron pas kësaj? Çfarë nevojë kemi ne për të? A është Allahu xh.sh. i nevojshëm për ne, apo ne jemi për Të?

Hikmeti apo mençuria nga kjo shihet se jeta e shoqërisë njerëzore nuk nivelizohet dhe nuk stabilizohet në mënyrën e duhur nëse në zemrat e kësaj shoqërie nuk mbizotëron frika nga Allahu xh.sh. dhe mbikëqyrja e Tij, sepse vetëm në këtë mënyrë të drejtat e popullit mund të sigurohen në mënyrën më të duhur.

Më lejoni që të zgjerohem pak më tepër në komentimin e këtij problemi. Ka qenë vullnet i Allahut të madhëruar që filozofia e kësaj jete t'i ketë dy kahe të rëndësishme: atë pozitive dhe atë negative. Dikujt kjo jetë i kthehet me të gjitha të mirat dhe begatitë e saj dhe, si rezultat i kësaj, kur njeriu sheh begatinë dhe hijeshinë e kësaj jete, atij i futet në zemër mendjemadhësia, mendon se materia e kësaj jete është qëllimi final i njeriut, nuk brengoset për ndryshimet dhe problemet e kësaj jete, i futet në zemër egoizmi dhe nuk i intereson çështja e askujt.

Ndërsa dikujt tjetër kjo jetë i kthehet në brengosje, goditje (dhimbje) etj. dhe, si pasojë i këtij procesi, njeriu i futet në zemër një brengosje e madhe dhe ai fillon ta shikojë dhe ta logjikojë çështjen e kësaj jete si një burg të mbushur plot dhimbje dhe ndëshkime, në krahasim me ata të cilët kënaqen dhe dëfrehen me epshet e kësaj jete. Ky person ndalet, logjikon

mendon gjatë dhe vjen në konkludimin se, për të, është më mirë që ta vrasë veten dhe në këtë mënyrë të rehatohet.

Ligji dhe tradita e kësaj jete nuk ndryshon dhe do të qëndrojë e tillë deri në ditën e fundit të kësaj jete dhe Allahu xh.sh. do t'i sprovtojë njerëzit me këto dy sprova të rënda. Mirëpo neve na intereson se si ta gjejmë mënyrën që të dalim nga kjo grackë e rrezikshme dhe si të korrим sukses? Njerëzit, filozofët dhe psikologët më të mëdhenj botërorë nuk kanë mundur që të arrijnë në një përfundim të frytshëm që të shpikin dhe të zbulojnë një bar, me qëllim që atë që kënaqet me epshtet e kësaj jete ta dirigjojnë dhe ta bëjnë të sjellshëm në mënyrë që të mos t'i kalojë kufijtë me mëkate, dhe që atë të brengosurin ta shpëtojnë nga brengat e kësaj jete.

Shpëtimi i suksesshëm dhe i sigurt nga kjo vuajtje shpirtërore është që njerëzit të ndjekin recetën të cilën Allahu xh.sh. ua ka dhënë robërve të Tij, e kjo është që zemra të jetë e lidhur me fjalën (përmendjen) e Allahut xh.sh. E kur të veprojnë në këtë mënyrë, atëherë njeriu do të ruhet nga rreziqet dhe problemet e kësaj jete.

Përmendja dhe përkujtimi i Allahut xh.sh. i sjell njeriut dy të mira të mëdha.

E para është se ajo i sjell njeriut qetësi dhe rehati dhe ja mbush zemrën më frikë dhe kujdes.

Qetësia dhe rehatia është për atë të cilit kjo jetë ia ka kthyer shpinën dhe e ka sprovuar me sprova të rënda, ndërsa frika dhe kujdesi është për atë të cilit kjo jetë i është dhënë me të gjitha të mirat e saj.

Shih se si e kristalizon këtë realitet Allahu xh.sh., me fjalët e Tij në Kur'anin e madhëruar, duke thënë:

“Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen; pra ta dini se me të përmendur Allahun zemrat stabilizohen.” [Suretu Er-Rra'd-28.]

Përsëri Allahu xh.sh. thotë:

“ Të tillët janë besimtarë të vërtetë dhe për këtë kanë vende të larta te Zoti i tyre, kanë falje dhe kanë furnizim në mënyrë të ndershme.” [Suretu El-Enfale-4.]

Prej nga vjen qetësia e zemrës? Ajo vjen nga bindja e madhe që ka përkujtuesi në zemrën e tij se kjo jetë, me të gjitha të mirat e saj, konsiderohet si një ëndërr që dikush e sheh natën në gjumë, e pas ëndrrës agon mëngjesi i vërtetë me të gjitha ngjyrat e kësaj jete. Po ashtu qetësia e zemrës vjen nga bindja e madhe tek Allahu xh.sh. se asgjë nuk humb tek Ai.

E nga vjen frika e zemrës prej Allahut xh.sh.? Ajo vjen nga bindja në fjalën e Allahut xh.sh. në Kur'an:

“dhe do të përgjigjeni në ditën e gjykimit për të mirat (kënaqësitë) e kësaj jete.” [Suretu Et-Tekathur-8.]

E kur të bashkohen frika dhe qetësia, dy komponentë këto me rëndësi të madhe, atëherë nga këto të dyja sigurohet rehatia dhe kënaqësia në këtë jetë.

4- DITURIA E VËRTETË – BAZAMENT I MORALIT DHE BESIMIT

Allahu xh.sh. në Kur'anin famëlartë thotë:

“Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të parët dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi.” [Suretu El-Israe, 36.]

Allahu xh.sh., me këtë ajet kur'anor, na ndalon qartazi që të ndjekim ndonjë ide apo besim përderisa nuk kemi argument të fortë dhe të sigurt rreth çështjes në fjalë, qoftë ai argument në aspektin e besimit apo të moralit.

Ky ajet kur'anor përmban edhe një ligj tjetër, e ai është që dituria e saktë dhe e vërtetë duhet të jetë kriter për të gjitha problemet, në tërë sferat e jetës.

Çka do të thotë fjala dituri (*Ilm*), apo ç'është dituria?

Dituri është të dish ose të kuptosh diçka ashtu si është në realitet, qoftë ajo çështje konkrete apo abstrakte. Pa dyshim, supozimet nuk mund t'i quajmë dituri, mirëpo këto janë rrugët që na shpjen drejt diturisë, e ne ende nuk i kemi kaluar këto rrugë.

Ku qëndron mençuria në këtë çështje dhe çfarë dëmi i shkaktohet njeriut nëse ai i mbyll sytë e tij para realitetit dhe argumenteve të vërteta?

Përgjigjja është se ky ligj (vendim) ka lidhshmëri të fortë me vendimin themelor, e ai është domosdoshmëria e besimit në Allahun xh.sh. dhe nënshtrimi ynë ndaj ligjeve të Tij.

Për të arritur deri te besimi në Allahun xh.sh. duhet të ndiqet rruga e diturisë së saktë dhe e bindjes së fortë. Ne duhet t'iu shmangemi supozimeve dhe mendimeve të pabaza, përndryshe ndjekja e kësaj rruge të dyshimtë kishte për të qenë tejet e rrezikshme.

Ky është shkaku i devijimit të ateistëve në çështjen e ekzistencës së Allahut xh.sh., pra bazimi i tyre në supozime dhe ide të pabaza (*dhunun*), e jo në dituri të vërtetë.

Ndërsa shkaku i mosdevijimit të besimtarëve dhe i besimit të tyre në Allahun xh.sh. është se ata kanë qenë dhe janë bazuar në dituri të vërtetë (*ilmul-jekijm*). Këta të tillët Allahu xh.sh. i ka përmendur në Kur'an.

Përveç mençurisë që u cek më lart, një mençuri tjetër është se njeriu influencohet nga ambienti ku jeton dhe, në të shumtën e rasteve, ai i nënshtrohet mendimeve dhe supozimeve të ndryshme që janë të pabaza, si p.sh. fjala vjen: dyshimi i tij për dikë tjetër, rezistenca e tij ndaj dikujt tjetër, egoizmi, epshet dhe qëllimet e tij të ndryshme. Me kësi lloj problemesh ballafaqohen popujt dhe njerëzit. E shpëtimi i njeriut nga këto kurthe dhe gracka është që ai ta pastrojë kokën dhe zemrën e tij nga

këto mendime të dyshimta dhe të pabaza. Ndonjëherë njeriu e urren dikë tjetër, i nënshtrohet ligjeve të mendjes së vet dhe fillon të flasë kundër tjetrit. Kurse ndonjë tjetër ballafaqohet me ndonjë problem të kësaj jete dhe fillon ta gjykojë me mendjen e tij se si të shpëtojë nga ky preokupim. Ndërsa ndonjë tjetër e mundon fanatizmi familjar ose fisnor dhe lufton kundër dikujt tjetër për këtë fanatizëm familjar ose fisnor, duke mos u bazuar tek realiteti dhe tek e vërteta (*hak*) etj. Kjo dukuri apo kjo sëmundje, pra kur logjika e vërtetë dhe mendja e kulluar nuk gjykon sipas ditorisë së vërtetë por robërohet dhe i nënshtrohet problemeve të kësaj jete, konsiderohet një lloj robërie nga më të rrezikshmet.

Si të lirohemi nga kjo robëri dhe si të shërohemi nga kjo sëmundje? Lirimi nga kjo robëri vjen kur njeriu mbështetet dhe bazohet në peshojën e ditorisë së vërtetë dhe kërkon ndihmë me mjetet me të cilat Allahu xh.sh. e pajisi njeriun: mendja, të dëgjuarit, të shikuarit dhe shqisat e tjera. Kur njeriu fillon t'i përdorë këto mjete, duke e pasuruar dhe zgjeruar diapazonin e tyre, atëherë si rezultat i kësaj do të jetë se efekti i atyre problemeve, në ambientet e ndryshme që i thamë më lart, do të reduktohet dhe ato nuk do të ndikojnë negativisht.

S'do mend se ata, të cilët janë të dyshimtë dhe labilë, janë më larg nga fusha e ditorisë së vërtetë, ndërsa ata të cilët ballafaqohen dhe merren me dituri dhe me qëllime të sigjerta janë më afër hakut dhe janë më stabilë.

Shkaku i rëndësisë së mendjes dhe i shqisave të tjera ka qenë se njeriu është obliguar me amanetin më të madh, për të cilin, nëse e humb atë, do të përgjigjet para Allahut xh.sh., gjë për të cilën flet qartazi edhe ajeti kur'anor, dhe se ai person do të llogaritet nesër për këto të mira nga Allahu xh.sh. Allahu xh.sh. thotë "*pse të dëgjuarit, të parët dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi.*" [Suretu El-Israe, 36.]

5- ETIKA E SHKUARJES NË XHAMI

Allahu xh.sh. në Kur'an thotë:

“O bijtë e Ademit, vishuni bukur sa herë që shkoni në xhami për t’u falur, hani dhe pini e mos shpenzoni, se me të vërtetë Allahu xh.sh. nuk i do ata që shpenzojnë.” [Suretu El-A’rafe, 31]

Ky ajet kur’anor përmban dy ligje dhe principe të rëndësishme, që kanë të bëjnë me shoqërinë njerëzore. Ne, nga këto dy principe, na intereson principi i parë, e ai është parapërgatitja e muslimanit para se të shkojë në xhami.

Zbritja e këtij ajeti kur’anor ka qenë edhe për një qëllim dhe synim tjetër. Ky ajet ka zbritur për ta korrigtuar një vepër tejet të shëmtuar që vepronin arabët në xhahiljet. Ata sillëshin rreth Qabesë (bënin tavaf) të zhveshur dhe duke fishkëllyer.

Po ashtu, ky ajet kur’anor përmban në konstruksionin e tij edhe një princip tjetër shumë të rëndësishëm me dimension bashkëkohor, e ai është që ne duhet të vishemi me rroba të pastra jo vetëm në Qabe kur bëjmë tavaf, por edhe në xhamitë e tjera sa herë që shkojmë për t’u falur. Nëse kuptohet qëllimi i mbulesës së trupit të njeriut dhe arsyeja e saj, atëherë ku qëndron shkaku dhe mençuria e parapërgatitjes së njeriut për të qenë i pastër kur shkon në xhami ?

Shihet se shkaku qëndron në faktin, - dhe për këtë qëllim të lartë janë ngritur dhe janë ndërtuar xhamitë për të falur namazin, - e të tubuarit të muslimanëve në një vend, të njoftuarit e tyre në mes vete dhe të përforcuarit e vëllazërim bashkimit islam në mes tyre, sepse ka qenë e mundur për çdokënd që ta falë namazin në shtëpinë e tij dhe ndoshta ky person kishte për të qenë më rahat dhe më i qetë. Mirëpo Allahu xh.sh. ka preferuar edhe ka paraparë diçka që është më mirë dhe më e qëlluar, dhe mu për këtë e ka shumëfishuar shpërblimin e faljes së namazit në xhami për njëzet e shtatë shkallë.

Për këtë arsye dijetarët islamë janë të një mendimi dhe kanë thënë se ai i cili dëshiron të shkojë në xhami për ta falur namazin me xhemat dhe nga ai kundërmon erë jo e këndshme, si p.sh: ka ngrënë hudhra apo qepë, ose diçka të ngjashme me të, atëherë kjo gjendje aktuale e tij konsiderohet arsye fetare që ai të mos shkojë në xhami, bile preferohet që ai ta falë namazin në shtëpinë e tij.

Po ashtu, edhe ai i cili e lëshon punën apo shitoren e tij për të shkuar në xhami për ta falur namazin me xhemat, mirëpo rrobat i ka të përlyera ose me erë jo të këndshme, gjë që nuk i përshtatet xhamisë (si p.sh; *mishshitës-farkëtar-mekanik* etj., sh.p.), të gjitha këto raste konsiderohen

arsye fetare të pranuar që ai të mos shkojë në xhami për ta falur namazin me xhemat dhe se për atë preferohet më tepër që ta falë namazin në vendin e punës (*në shitore, në arë, etj, sh.p.*).

Sa herë që tubimi në një xhami bëhet më i madh, aq më obligative bëhet pastërtia nga ana e Allahut xh.sh. dhe mu për këtë arsye juristët islamë (*fukahat*) janë të gjithë të një mendimi dhe kanë rënë në konsensus (*Ixhma'e*) se pastrimi i tërësishëm i trupit (*gusli*) në ditën e xhumasë është i preferuar (*mustehab*). Po ashtu, juristët islamë janë të mendimit se është e preferuar edhe veshja e rrobave më të mira dhe parfumimi me erë të këndshme.

E tërë kjo parapërgatitje bëhet që takimi në mes të besimtarëve ta arrijë kulminacionin e dashurisë, të vëllazërimit dhe të bashkimit islam, dhe që nga mesi i tyre të largohen shkaqet e përçarjes dhe të hidhërimit. Besimtarët nuk mund të vëllazërohen e të duhen ndërmjet vete, dhe ndarjet personale nuk mund të zhduken nga ata, nëse ata nuk rreshtohen të gjithë së bashku në xhami para madhërisë së Allahut xh.sh. Ashtu sikurse njeriu gëzohet kur përshëndetet me selam dhe vepron dhe punon për ta forcuar dashurinë dhe vëllazërimin islam, po ashtu edhe pastërtia luan një rol të rëndësishëm pozitiv për ta realizuar këtë qëllim të dashurisë islame.

6- ISLAMI NUK PRANON IMITIM TË ÇORODITUR

Allahu xh.sh. në Kur'anin famëlartë thotë:

“E kur u thuhet atyre (idhujtarëve): “ *Pranoni atë që Allahu e shpalli ! Ata thonë: “Jo, ne ndjekim atë rrugë në të cilën i gjetëm prindërit tanë! Edhe sikur prindërit e tyre të mos kenë kuptuar asgjë dhe të mos jenë udhëzuar në rrugën e drejtë ”* (ata do t'i pasonin)?” [Suretu El-Bekare, 170.]

Ky ajet, dhe shumë ajete të tjera të Kur'anit, i kritikon ata të cilët e kanë marrë imitimën e të tjerëve si program të jetës së tyre. Ky ajet i ndalon në veçanti muslimanët nga kjo vepër d.m.th.: imitimi i të tjerëve në mënyrë të verbër dhe të çoroditur, duke mos e peshuar atë vepër apo atë sjellje me peshoren e së vërtetës (*hakkut*) dhe të drejtësisë islame (*Kur'anit dhe sunnetit, sh.p.*)

Duke u bazuar në atë që u tha më lart, është marrë vendim i prerë nga dijetarët islamë se imitimi i të tjerëve në çështje të besimit (*akides*) nuk pranohet dhe nuk lejohet, dhe se besimi i atij, i cili thotë se unë jam besimtar për arsye se e kam familjen besimtare ose ambienti në të cilin jetoj ma obligon atë, nuk është i vërtetë dhe i qëlluar, ashtu si e kërkon Allahu xh.sh.

Duke u nisur nga ky realitet, ata të cilët obligimet fetare si p.sh. *namazi, agjërimi, haxhi* dhe vlera të tjera të moralit Islam, i quajnë tradita fetare islame, ata kanë gabuar dhe janë shmangur nga rruga e drejtë, sepse fjala traditë në terminologjinë e lingistikëve dhe sociologëve nënkupton një grumbull zakonesh të cilat baballarët i kanë trashëguar prej stërgjyshërve, ose zakonet e përfituara nga një shoqëri ose popull i huaj si pasojë e kontaktit të afërt me ta. Ndërsa ligjet e Allahut xh.sh. nuk janë të këtij lloji. Ato janë parime të larta hyjnore për interesin e njerëzisë, për të mirat e kësaj jete dhe të ahiretit.

Mençuria (hikmeti) e kësaj ndalese, që mos t'i emërojmë parimet islame me emrin tradita, është e qartë dhe e ditur, sepse kjo bie në kundërshtim me autoritetin dhe nderin e njeriut dhe logjikën e tij të shëndoshë, me të cilën Allahu xh.sh. e ngriti njeriun lart mbi krijesat e tjera.

Allahu xh.sh. na ka obliguar ne me këtë fe që të jemi të nderuar, të lartë dhe të respektuar, e kurrsesi të ulur dhe të poshtëruar. Mandej, nëse ti nuk ke mundur ta kuptosh prej ligjeve të Allahut xh.sh dhe parimeve islame se ato nuk janë gjë tjetër veçse tradita, atëherë ky është faji i yt dhe është kundër favorit tënd, sepse ti si intelektual nuk ke mundur të bësh diferencën lingvistike në mes traditës dhe parimit. Mu për këtë arsye, ata të cilët i konsiderojnë parimet islame si tradita dhe zakone largohen shumë shpejt nga këto parime.

E nëse ata i konsiderojnë ligjet e Allahut xh.sh. si parime, obligime dhe status jete dhe nëse këto ligje aplikohen dhe zbatohen ashtu si kërkon krijuesi ynë, Allahu xh.sh., atëherë popullit do t'i sigurohet rehatia dhe kënaqësia në këtë jetë, ndërsa po qe se populli i lë anash dhe nuk i përfill këto obligime hyjnore, atëherë padyshim se kjo gjë do t'u sjellë atyre jo rehati dhe mizori në këtë jetë. Prandaj kush i ka kuptuar këto parime si ligje të Allahut xh.sh, ai është më i devotshmi dhe më afër Allahut xh.sh. Lufta ideologjike kundër muslimanëve zhvillohet në shumë mënyra dhe në shumë metoda, dhe njëra nga mënyrat është edhe kjo dukuri negative, pra që ligjet dhe parimet e Allahut xh.sh. të reklamohen dhe të komentohen para masës muslimane se nuk janë gjë tjetër veçse një grumbull zakonesh apo traditash që kanë trashëguar prindërit tanë nga gjyshërit e tyre. Ato vazhdojnë të propagandohen në këtë mënyrë me qëllime dhe synime të shumta, derisa të kalojë një kohe e gjatë dhe njerëzit fillojnë të harrojnë që në realitet ato janë ligje dhe parime që bazohen në logjikë të shëndoshë dhe në argument. Si pasojë, armiqve të Islamit u lehtësohet sulmi dhe luftimi i ligjeve të Allahut në emër të lirisë (*dhe të demokracisë, sh.p*) me titullin 'luftimi i traditave', kur populli po angazhohet të gjejë lirinë. E që muslimanët të mos bien në kurthin e tyre, ata duhet ta dinë dhe të përkujtojnë gjithmonë se ligjet e Allahut xh.sh. janë parime hyjnore dhe se mu për këtë arsye Kur'ani e ka ndaluar imitimimin e të tjerëve dhe i ka ndaluar etërit tanë që t'i trashëgojnë dispozitat e fesë nga të tjerët. Ato që janë në përputhje me fenë duhet t'i marrin, ndërsa ato të cilat janë në kundërshtim me fenë duhet të lihen anash.

Duhet të dimë edhe një gjë me rëndësi të madhe: dispozitat e Allahut xh.sh, me të cilat jemi të ngarkuar, qoftë në aspektin doktrinar të besimit apo në aspektin social dhe njerëzor, kanë për qëllim që ta rregullojnë jetën tonë në këtë botë dhe që ta përfitojmë kënaqësinë e Allahut xh.sh. në botën tjetër, e kurrësi nuk guxojmë që ato ligje t'i quajmë tradita të trashëguara nga stërgjyshërit.

7- ETIKA E SHITJES DHE E BLERJES

Allahu xh.sh. në Kuranin famëlartë thotë:

“Masën mbusheni kur matni (me enë) dhe peshoni me peshojë të drejtë (precize). Kjo është më e dobishme dhe ka përfundim më të mirë”. [El Isra, 35.]

Allahu xh.sh., me këtë ajet madhështor, na urdhëron që të realizojmë një formë nga format më të dukshme të drejtësisë, e ajo është saktësia në peshojë në mes dy palëve gjatë shitjes dhe blerjes. Ky urdhër kur'anor përsëritet disa herë në Kur'an dhe Allahu xh.sh iu kërcënohet atyre të cilëve nuk i nënshtrohen këtij urdhri të Tij. Këtë e potencon edhe vetë Allahu xh.sh. në Kur'an, në një ajet tjetër, ku thotë:

“Të mjerët ata që mangut masin e peshojnë. Ata që kur matin prej njerëzve, për vete e plotësojnë, e kur u matin ose u peshojnë të tjerëve, u lënë mangut.” [Mutaf-fifijn, 1-3.]

Në ajetin e parë Allahu xh.sh. urdhëron që të jemi të drejtë dhe të sinqertë gjatë shitjes dhe na rikujton se kjo drejtësi është më e mirëseardhur dhe më e dobishme në të ardhmen, dhe kurrësi mos gaboni që të mashtroheni me një fitim të shpejtë të kësaj jete gjatë mashtrimit të të tjerëve.

Kjo vepër është e urryer. Ky fitim, nga ky mashtrim dhe manipulim i popullit, shndërrohet në humbje dhe ngatërresa të rënda, dhe mu këtu shihet një pjesë e arsyes dhe e mençurisë së këtij urdhri kur'anor.

Allahu xh.sh., me këtë ajet kur'anor, na bën të ditur se padrejtësia në fillim duket e këndshme dhe fitimprurëse, e kjo e bën personin në fjalë që ai ta vazhdojë dhe të zhytet më shumë në këtë padrejtësi dhe në këtë vjedhje, derisa të bëhet i njohur në treg për këtë gjest të pamoralshëm dhe ta humbasë autoritetin dhe besimin e tij në masë, për arsye se është i bërë i njohur për vjedhje dhe kështu, gradualisht, ai humbet totalisht.

Ky përfundim i keq vjen si rezultat i fitimit nga mashtrimi i popullit në fillim të tregtisë. Ja pra ky ishte komentimi i ajetit në fjalë *“kjo është më e dobishme dhe ka përfundim më të mirë.”*

Ndërsa arsyeja dhe mençuria tjetër e këtij urdhri kur'anor qëndron në faktin se marrëdhëniet e sinqerta dhe të drejta në mes muslimanëve shpiten në përforcimin e dashurisë dhe të sigurisë në mes tyre, dhe se

dashuria në mesin e tyre forcohet aq sa ata janë të drejtë dhe të saktë në marrëdhëniet e tyre në mes vete.

Po edhe anasjelltas, mungesa e sinqeritetit dhe e drejtësisë në mes tyre, përhapja e korrupsionit dhe e vjedhjes në mesin e tyre, është shkaku më i madh dhe më kryesor për përçarjen, ndarjen, hidhërimin, xhelozinë dhe urrejtjen e muslimanëve në mes vete.

Ajeti i lartpërmendur vë në shënjestër këtë mashtrim dhe këtë vjedhje të thjeshtë dhe të vogël në peshojë, duke mos u futur në detajet e metodave të tjera të mashtrimit, dhe e ndalon rreptësisht këtë vjedhje edhe pse është ndoshta e thjeshtë dhe nuk mund të vërehet gjatë shitjes apo blerjes, sepse çdo vepër e keqe dhe e ndaluar në fillim praktikohet ngadalë, duke mos i kushtuar rëndësi rrezikut të saj. Në këtë mënyrë, personi vazhdon të zhytet në haram dhe, dalëngadalë, më vonë, ky person zbulon metoda të reja të vjedhjes dhe të mashtrimit dhe, kështu, tregtia e tij që ishte hallall shndërrohet në haram, për arsye se ai po e merr pasurinë e të tjerëve në mënyrë joligjore.

Kjo është një metodë dhe një stil i lartë i Kur'anit, me të cilin ai veçohet nga çdo libër tjetër. Kur ai e ndalon ndonjë vepër të keqe, gjithmonë e ndalon me qëllim që njeriu të mos zhytet në haram qysh në shkallën e parë. Po ashtu, Kur'ani i ndalon shkaqet paraprake që shpien në haram, dhe, në të shumtën e rasteve, ai nuk i tregon pasojat e veprave të këqija. Gjithmonë, në fillim, Kur'ani i kushton rëndësi faktit që të mos i mashtrojmë të tjerët, sepse mënyra e vetme që të shpëtojmë nga harami është që të mos i trasojmë gjurmët e haramit dhe të mos ecim shtigjeve të tij.

E kur njeriu i futet rrugës së haramit dhe arrin në mes, atëherë e ka shumë vështirë të kthehet prapa. Janë shumë të paktë ata të cilët kanë shpëtuar dhe janë kthyer prapa.

Mu për këtë arsye, Allahu xh.sh. na ndalon gjithmonë që mos t'i afrohemi haramit apo shkatërrimit. Allahu xh.sh. thotë:

“Dhe mos iu afroni të këqijave çka janë të dukshme dhe të padukshme apo të fshehta.” [El En'am: 151]

Dhe përsëri Allahu xh.sh. thotë:

“Dhe mos iu afroni mallit të jetimit për ta ngrënë në mënyrë të padrejtë pasurinë e tij.” [El En'am: 152]

Po ashtu, Allahu xh.sh. thotë:

“Dhe mos iu afroni zinasë (prostitucionit), se me të vërtetë ajo është vepër e keqe dhe rrugë e shëmtuar dhe e urryer.” [El Isra:32]

8- MBËSHTETJA E BESIMTARIT NË LAJME TË VËRTETA

Allahu xh.sh. në Kur'anin famëlartë thotë:

“O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë, ashtu që të mos e goditni ndonjë popull pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë.” [El Huxhurat:6]

Vendimi ose ligji që ky ajet kur'anor synon ta vendosë është të vërtetuarit e çdo lajmi që muslimani dëgjon për vëllanë e tij musliman. Mos kujto se çdo lajm që të vjen në vesh është i vërtetë. Ky ajet kur'anor përfshin një urtësi të madhe në brendi të tij dhe aty qëndron baza dhe gur themeli për ngritjen e shoqërisë islame dhe atë humane.

Shtyllat e shoqërisë së pastër nuk mund të ngrihen nëse shoqëria nuk bazohet në ndihmën reciproke dhe në mbështetjen e njëri-tjetrit. Sa për ilustrim po japim një shembull të thjeshtë: po të mos ekzistojë ndihma reciproke e sinqertë në mesin e një grupi punëtorësh të ndonjë kompanie për të ngritur një ndërtesë, pa dyshim se ata nuk do të kishin mundur ta ndërtonin dhe ta ngrinin atë ndërtesë. Po ashtu, edhe ngritja e shtyllave të shoqërisë së pastër në Islam i ngjan këtij shembulli.

Hapi i parë për të arritur deri te ndihma shoqërore është konsultimi i drejtë dhe i sinqertë. Duke u bazuar në këtë realitet, Allahu xh.sh. na ka obliguar që të jemi të drejtë dhe të sinqertë dhe na e ka ndaluar gënjeshtrenë dhe hipokrizinë.

Mirëpo, nëse në mesin e popullit ekziston ndonjë individ i cili e ka zakon përdorimin e gënjeshtres për ndonjë interes të tijin personal dhe i cili nuk frikësohet nga Allahu xh.sh për këtë gjest jonjerëzor, atëherë çfarë mase preventive kishim për të marrë që kjo gënjeshtër të mos t'i japë frytet dhe pasojat e saj dhe në çfarë mënyre kishim për t'ia ndërprerë rrugën atij, i cili nëpërmjet kësaj vetie të ndytë dëshiron t'i realizojë epshet dhe qëllimet e tij?

Pa dyshim, se metoda e cila duhet ndjekur për të shpëtuar nga ky rrezik është që t'ua tërheqim vërejtjen të tjerëve dhe t'ju themi se çdo lajm që vjen nga ai person të mos merret për bazë, po ashtu duhen shfrytëzuar të gjitha mjetet që janë në dispozicion për t'u bindur nëse me të vërtetë lajmi i tij është lajm i vërtetë, kështu që më vonë të mos pendohemi nëse ai lajm ka qenë jo i saktë.

Ja pra, në këtë mënyrë sheriati islam na mëson se si t'i përdorim të gjitha mjetet që janë në dispozicion, në mënyrë që shoqëria njerëzore të ruhet e pastër. Në radhë të parë, ai e ka obliguar folësin që kur të flasë, të flasë drejt dhe mos të gënjejë dhe, në radhë të dytë, e ka obliguar dëgjuesin e lajmeve që mos ta marrë si të vërtetë çdo lajm dhe çdo fjalë.

Urtësia që fshihet në këtë çështje qëndron në faktin se shoqëria islame duhet të jetë e siguruar dhe e vëllazëruar në mes vete, pasi ajo çka më së shumti e prish shoqërinë dhe i shkatërron familjet është rrena dhe gënjeshtërtia. Në një shoqëri të sëmurë askush nuk i frikësohet Allahut xh.sh.: ai i cili flet gënjen, ai i cili dëgjon beson çdo gjë. Në këtë mënyrë përhapet ngatërresa dhe hidhërimi, shoqëria nuk mund të dalë nga krizat sociale dhe morale dhe kështu shkohet deri te copëtimi i shoqërisë, në vend se ajo të qëndrojë e lidhur dhe e fortë.

Nëse folësi do ta kishte ruajtur gjuhën e tij nga rrena dhe dëgjuesi veshin e tij nga lajmet e pabaza, nuk kishin për të ndodhur probleme dhe ngatërresa. Këtu shihet madhëria e Allahut xh.sh., i Cili në një ajet kur'anor thotë: “O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë, ashtu që të mos e goditni ndonjë popull pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë”.

9 - LARGIMI NGA SHOQËRIA E KEQE

Allahu xh.sh. në Kur'anin famëlartë thotë:

“Juve u është shpallur në librin (Kur'anin) që, kur të dëgjoni se po mohohet Kur'ani i All-llahut dhe po bëhet tallje me të, mos rrini me ata derisa të mos hyjnë në bisedë tjetër. Përndryshe, ju do të jeni si ata. All-llahu do t'i tubojë tradhtarët dhe jobesimtarët që të gjithë në xhehenem.”
[En Nisa: 140]

Në këtë ajet kur'anor shihet qartë se muslimani nuk guxon të flasë ose të dëgjojë diçka që është e ndaluar prej bisedave të kota, e pastaj të mos tentojë të largohet vetë nga ajo e keqe, ose ta largojë atë të keqe me dorën e tij.

Po ashtu, në këtë ajet kur'anor, vërehet mirë kërcënimi i Allahut xh.sh. ndaj atyre personave që rrinë së bashku me ata të cilët tallen me dispozitat dhe ligjet e sheriatit islam e nuk largohen nga ai mjedis apo kuvend i tyre, sepse heshtja e tyre nënkupton pajtimin e tyre me ato për të cilat ata flasin dhe bisedojnë.

Sa i përket vendimit (hukmit) dhe ligjit fetar se: - A bën të rrihet dhe të qëndrohet në një kuvend apo mexhlis ku të tjerët tallen me Kur'anin famëlartë? – s'do mend se përgjigjja definitive dhe përfundimtare e të gjithë ulemave dhe dijetarëve islamë është se të qëndruarit në atë mjedis është haram dhe i ndaluar rreptësisht.

Ndërsa sa i përket urtësisë dhe fshehtësisë se kësaj ndalesë, kjo temë do të diskutohet tani dhe ka të bëjë me bazat e edukatës shoqërore.

Ndoshta dikush do të habitet nga kjo ndalesë e rreptë e Kur'anit dhe thotë: çfarë dëmi kam unë nëse e shoh të keqen, por nuk e punoj atë dhe nuk ballafaqohem dot me të? Apo çfarë dëmi ka nëse unë dëgjoj ndonjë bisedë boshe dhe pa peshë të rëndë?

Rreziku i këtij problemi qëndron në faktin se nëse muslimani e shfrenon veten e tij për të parë të keqen dhe për ta dëgjuar atë, atëherë ai gradualisht, në radhë të parë do të ushtrohet për ta parë të keqen, në radhë të dytë do të pajtohet dhe përshtatet me të, e në radhë të tretë ai do ta veprojë atë dhe do të mundohet ta arsyetojë atë.

Për ta kuptuar më mirë këtë fenomen, hidhni një vështrim tek ata besimtarë të cilët veprojnë dhe punojnë në mesin e shoqërisë europiane në Perëndim. Ata, në fillim, kur shkojnë në Perëndim ngushtohen shumë dhe u vjen turp për atë se çka po shohin dhe çka po dëgjojnë, e ngrenë zërin e protestës dhe paraqesin shqetësimin e tyre kundër veprave dhe sjelljeve të ndaluara. Pas një kohe të shkurtër, ata qetësohen dhe pajtohen me atë çka po shohin dhe dëgjojnë, e mandej më vonë edhe pajtohen me të, edhe pse e dinë se kjo është haram!

Me kalimin e kohës, edhe ata fillojnë t'i mbrojnë ato ide dhe e shohin këtë si çështje kohore, dhe se nuk bën ndryshe vetëm se kështu, duke u justifikuar dhe argumentuar se ata janë në perëndim, në vend të përparuar... Dhe kështu, në fund, urrejtja ndaj të keqes shndërrohet në dashuri ndaj saj!!!

E kur muslimani arrin deri në këtë gjendje, pajtohet me të keqen, nuk brengoset fare për të dhe nuk e kundërshton atë, atëherë shpërblimi për të është zjarri i xhehenemit, ku ai do të futet së bashku me kriminelët e tjerë. Për këtë arsye është haram që muslimani të shpërngulet në Perëndim për të jetuar atje, pa ndonjë arsye të madhe, si p.sh. studimi, puna për të siguruar kafshatën e gojës etj.

Ndoshta dikush mendon se nuk ka nevojë për këtë ligj dhe mendon se ky ligj është ngushtim për popullin. Mirëpo nëse jemi të bindur dhe pajtohemi me faktin se njeriu e përfiton moralin e tij nga ambienti ku jeton, e pastaj edhe i përshtatet atij, atëherë mund të konkludojmë se ligji i Allahut xh.sh., që u cek më lart, duhet të praktikohet dhe të merret për bazë edukativo-arsimore. Pikërisht për këtë arsye ligji i Allahut xh.sh. ka qenë i prerë edhe në një vend tjetër në Kur'an ku thuhet: *“Engjëjt që ua marrin shpirtin atyre që ishim mizorë dhe zullumqarë ndaj vetes, iu thanë: në çka ishit ju? Ata thanë: ne ishim të paafte në atë tokë. Engjëjt iu thanë: a nuk ishte e gjerë toka e Allahut xh.sh. e të emigroni në të (e ta praktikoni fenë e Allahut xh.sh.)? Vendi i tyre është xhehenemi, sa vend i keq është ai.”*

Nga këta përjashtohen ata të cilët kanë shkuar në Perëndim për studim, të cilin nuk mund ta marrin tjetërkund, ose për të fituar për mirëmbajtjen e familjes, me kusht që të jenë të kujdesshëm dhe të vendosur për ta ruajtur besimin dhe moralin e tyre, në çdo aspekt, nga sulmet e armiqve të brendshëm dhe të jashtëm.

10- ETIKA E DHËNIES SË SADAKASË PËR HIR TË ALLAHUT XH.SH.

Allahu xh.sh. në Kur'anin famëlartë thotë:

*" O ju që besuat, jepni nga më e mira e asaj që e fituat dhe nga ajo që ju dhamë prej tokës, e mos nxitoni ta jepni atë më të pavlefshmen nga ajo, e që ju nuk do ta pranoni për vete pos symbyllas. Dhe dini se All-llahu nuk ka nevojë për ju, ngase është i Madhëruar" **El bekare:267.***

Dihet se dhënia e lëmoshës për hir të Allahut xh.sh., për të varfrit dhe nevojtarët, konsiderohet si një prej veprave më të mira dhe më të pëlqyera, për të cilin muslimani shpërblehet tek Allahu xh.sh. Mirëpo për ta fituar dhe merituar këtë shpërblim duhet të përmbushen ca kondita dhe ca parime përkitazi me çështjen në fjalë.

Prej kushteve dhe konditave më kryesore është ajo çka u përmend më lart në ajetin kur'anor: ajo që jepet duhet të jetë prej atyre gjërave të mira dhe të pastra që i fiton besimtari dhe që është 100% hallall, si dhe duhet të jepet ajo që natyra e pastër e besimtarit e pranon si ushqim për veten e tij, dhe nuk ka hije që të jepet ushqimi i keq dhe i dobët. Ky person, po ashtu, duhet të llogarisë që këtë ushqim të keq që po e jep, a kish për ta pranuar për veten e tij po të kish dalë në treg për të blerë? Përgjigjja dihet, se kurrë jo, e atëherë si guxon ai që atë ushqim që nuk e pëlqen për vete t'ia japë dikujt tjetër?!

Ja pra ky ishte ligji i përfituar nga ajeti kur'anor dhe vendimi i prerë të cilin e ka përmendur Allahu xh.sh. me një stil të lartë edukativ. Por tani duhet ta dimë arsyen dhe fshehtësinë e këtij vendimi të përfituar nga ajeti kur'anor.

Urtësia e këtij ajeti shihet në faktin se Allahu xh.sh., kur i dalloi robërit e Tij dhe i klasifikoi ata sipas pasurisë, disa i bëri më të pasur e disa të tjerë më të varfër, dhe kur Allahu xh.sh. i urdhëroi të pasurit që t'u japin të varfërve, Ai nuk desh që të pasurit ta rrisin mendjen e tyre dhe të bëhen më superiorë ndaj të varfërve dhe t'ua dhurojnë atyre mbeturinat e ushqimeve që ata vetë nuk do t'i pranoin.

Ky gjest jo i pëlqyer nga ata, edhe nëse nuk bëhet shkak për dënimin dhe hidhërimin e Allahut xh.sh., në të njëjtën kohë nuk mund të bëhet shkas për ta fituar shpërblimin e Allahut xh.sh.

Kush e ndjek këtë rrugë dhe këtë mënyrë të dhënies së pasurisë së keqe, pa dyshim se ai person ka për të shkaktuar probleme dhe shqetësime në mesin e atyre të varfërve, duke ua ulur autoritetin dhe karakterin e tyre njerëzor, e Allahu xh.sh. nuk dëshiron që të ulet autoriteti i njeriut dhe

karakteri i tij për pak pasuri. Sepse të jesh i varfër dhe krenar është më mirë dhe më e lumtur se sa të jesh i pasur e me karakter të ulur dhe të mposhtur. Mu për këtë arsye, Allahu xh.sh. në Kur'anin famëlartë thotë:

“Një fjalë e mirë dhe një lehtësim (që i bëhet lypësit) janë më të vlefshme se një lëmoshë që përcillet me të keqe. Allahu nuk ka nevojë për askënd dhe është i butë”. [El Bekare:263]

Allahu xh.sh. i ka urdhëruar të pasurit të japin në mënyrë që ata të sprovohen se cili nga ata po e ndan nga pasuria e tij atë më të mirën për të varfrin.

Mbi të gjitha, nga ato që u tha më lart, ky i pasuri duhet të gëzohet shumë dhe të jetë shumë falënderues dhe mirënjohës ndaj këtij të varfrit që ia pranoi lëmoshën dhe ia dha atij rastin për të fituar shpërblimin dhe kënaqësinë e Allahut xh.sh. Në këtë mënyrë e parasheh feja kulturën dhe edukatën e dhënies për hir të Allahut xh.sh. Dhënia e pasurisë në këtë mënyrë mbjell dhe kultivon respektin, dashurinë dhe mirëkuptimin në mes besimtarëve.

Pa dyshim se për Allahun xh.sh. kishte qenë e mundur që ta pasuronte çdo individ në mënyrë që të ishte i pavarur, mirëpo madhëria dhe mençuria e Tij deshi që njerëzit të jenë të lidhur në mes vete, që të ekzistojë solidariteti reciprok dhe vëllazëror në mes tyre, që shoqëria islame të jetë e bashkuar, e vëllazëruar dhe e fortë.

Mos harroni se qëllimi kryesor dhe final i krijimit të popullit dhe i njerëzisë në këtë botë është sprova dhe secili prej nesh duhet të shpejtojë në vepra sa më të mira dhe më të sinqerta. Allahu xh.sh. në Kur'anin e madhëruar thotë:

“ Ne bëmë njërin prej jush sprovë për tjetrin se a do të jeni të durueshëm. E Zoti yt është Ai i cili sheh çdo gjë.” [El Furkan: 20]

11- NDALOHET PËRBETIMI I SHPESHTË

Allhu xh.sh. në Kuranin famëlartë thotë:

“E mos e bëni Allahun xh.sh. peng të betimeve tuaja (kur betohemi në të) kur doni të bëni vepra të mira të silleni mirë dhe të bëni pajtim ndërmjet njerëzve. Allahu dëgjon të gjitha dhe i di.” [El Bekaretu: 224].

Nga ky ajet kur'anor vërehet qartazi se Allahu xh.sh. ndalon që emri i Tij të merret si mjet apo si faktor që dikush të bëhet i besueshëm, ose t'i obligojë të tjerët që t'i besojnë këtij, kur ky e përmend emrin e Allahut xh.sh. dhe betohet në të. Këtë e vërteton edhe një ajet tjetër kur'anor ku Allahu xh.sh. thotë: *“dhe ruani betimet tuaja”* d.m.th. mos u betoni në çdo çështje, të vërtetë apo jo. [El Maidetu:89]

Allahu xh.sh. i urren tepër ata të cilët përbetohen shpesh. Allahu xh.sh. në Kuran thotë: *“Mos e respekto askënd që betohet shumë dhe është i poshtër.”* [El kalem:10]

Shkaku apo urtësia e kësaj ndalese qëndron në dy pika me rëndësi tejet të madhe, për të cilat muslimani duhet të ketë shumë kujdes:

E para: Emri i Allahut xh.sh. duhet të jetë në shkallën më të lartë në ndjenjat dhe zemrën e muslimanit dhe, kur të përmendet Allahu xh.sh., besimtari duhet ta ndiejë madhërinë dhe frikën ndaj Allahut xh.sh. Kjo është një cilësi apo vepër të cilën Allahu xh.sh. e ka përmendur në Kuran, ku Ai thotë: *“E besimtarë të vërtetë janë vetëm ata të cilëve kur përmendet Allahu u rrëqethen zemrat e tyre ...”* [El Enfal:2]

Zemrat e atyre të cilët e përmendin emrin e Allahut xh.sh. dhe betohen në të për qëllime të ndryshme të shitjes, blerjes, fitimit të besimit ndaj atyre, në çdo moment dhe për çdo çështje të rëndësishme apo jo, nuk rrëqethen fare kur përmendet emri i Allahut xh.sh. dhe atyre nuk u shtohet aspak besimi kur lexohen ajetet e Tij nga Kurani.

Pjesa dërmuese e atyre personave e përmendin Allahun xh.sh. për interesat e tyre personale dhe kjo vepër e shëmtuar është edukatë jo e mirë. Rezultat i kësaj edukate jo të mirë është se zemrat e tyre përforcohen dhe bëhen të ngurta, e pastaj gradualisht largohen edhe nga besimi ndaj Allahut xh.sh.

Po ashtu, një gjest tejet i urryer dhe i ndaluar, i ngjashëm me të parin, është edhe kur disa persona, për interesat të tyre personale, e përdorin salavatën për Muhamedin a.s. Kur dikush gëzohet ose dëshiron të shesë apo të blejë diçka, bën salavat me qëllim që t'ua mbushi mendjen të tjerëve apo t'i bindi ata. Sipas mendimit të të gjithë dijetarëve islamë, kjo vepër është e urryer dhe e ndaluar rreptësisht për arsye se kjo konsiderohet një lloj nënçmimi për Muhamedin a.s., pasi emri i tij përmendet për motivet e kësaj jete.

E dyta: Betimi në emër të Allahut e obligon personin që të jetë i drejtë në fjalë e në vepër, sepse me këtë fjalë ai po e merr dhe po e konsideron

Allahun xh.sh. si dëshmitar të tij për fjalën dhe veprën e drejtë. E si mundet muslimani të ketë guxim dhe trimëri që ta marrë për dëshmitar Allahun xh.sh. për një fjalë apo vepër të rrejshme? Ai, me këtë vepër, po bën që Allahu xh.sh. ta zbresë hidhërimin e Tij mbi të dhe ta mallkojë atë. Mu për këtë arsye, nuk mund të tallemi me betimin, sepse betimi me ato kushtet dhe rregullat e veta të posaçme konsiderohet si një prej argumenteve më të forta në rastet e problemeve të ndryshme.

Prandaj nëse muslimani e vazhdon këtë gjest të keq dhe betohet për çdo rast apo çdo problem, betimi e humb vleftën e tij dhe, gradualisht me kalimin e kohës, këtij argumenti nuk i mbetet më aspak vlerë. Ndoshta betimi bëhet profesion për mashtrime dhe vjedhje dhe ky person e mbulon mashtrimin dhe vjedhjen e tij me anën e betimit të shpeshtë.

Kështu mbi ata persona zbret hidhërimi i Allahut xh.sh. Në këtë mënyrë humbet besimi i muslimanëve ndaj njëri-tjetrit dhe si pasojë shoqëria islame çrregullohet.

Le të kthehemi të gjithë, pra, në parimet kur'anore, le t'i praktikojmë ato dhe të largohemi nga kjo vepër e urryer të cilën Allahu xh.sh. na e ka ndaluar.

12 - RËNDËSIA E DHËNIES SË SELAMIT

Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë: *“Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im! Nuk mund të hyni në xhenet derisa të mos jeni besimtarë dhe nuk do të jeni besimtarë derisa të mos duhemi në mes vete. A dëshironi që t’ju tregoj për një gjë, që nëse e punoni do të hyni në xhenet?... Jepni selam në mes vete.”* [Muslimi-Tirmidhiu-Iben Maxhe-dhe Ebu Davudi.]

Muhamedi a.s., me këtë hadith të tij, na këshillon që të duhemi në mes vete dhe, po ashtu, ai na tregon se mënyra apo metoda më e sigurt për ta realizuar këtë qëllim të lartë është dhënia e selamit.

Të gjithë dijetarët e *din*-it islam janë të mendimit se një prej shenjave më të dukshme të fesë islame është dhënia e selamit, prandaj preferohet që kur muslimani të takojë vëllanë e tij musliman ta përshëndesë atë me selam. Kthimi i selamit është vaxhib, ndërsa kush nuk e kthen selamin është mëkatar.

Ai i cili i jep dikujt selam e ka shpërblimin tek Allahu xh.sh. më shumë se ai që e kthen selamin, edhe pse dhënia e selamit është synet (e preferuar), ndërsa marrja e selamit apo kthimi i tij është vaxhib (i detyrueshëm).

Dijetarët (fukahatë) e sheriatit kanë treguar se ky rast është një prej disa rasteve ku syneti (dhënia e selamit) e ka shpërblimin më të madh tek Allahu xh.sh. se vaxhibi (kthimi i selamit).

Sa i përket urtësisë dhe shkakut, se përse Allahu xh.sh. e ka preferuar për ne këtë simbol islam të rëndësishëm, shihet qartë se një prej veprave që e shton dashurinë, mirëkuptimin, vëllazërinë dhe që i pastron zemrat nga xhelozia dhe armiqësia është dhënia e selamit.

Këtë çështje mund ta ilustronjë edhe me një shembull konkret shumë të logjikshëm.

Po të kishim rastin të shihnim një lumë apo një ujë që rrjedh vazhdimisht në një vend, a kishte për të mbetur ndonjë ndyrësi në shtratin ku kalon uji apo lumi? Pa dyshim se jo. Po ashtu është rasti edhe me dhënien e selamit dhe përhapjen e tij në mesin e muslimanëve. Kur dhënia e selamit bëhet sinqerisht dhe me qëllime të mira në rrugë, në treg e kudo, atëherë edhe zemrat e muslimanëve pastrohen nga çdo veti e keqe, sikurse shtrati i lumit që pastrohet me ujë.

Pa dyshim se muslimanët e kanë harruar këtë moral të rëndësishëm islam, mirëpo po të ishin ndalur për të logjikuar pak për domethënien e fjalës apo shprehjes ‘es-selamu-alejkum’, kur muslimani e përshëndet vëllanë e tij, qoftë nëse e njeh apo jo, në rrugë, xhami, treg; dhe pastaj për përgjigjen ‘ve alejkumus-selam’ kishin për të parë, se cilësia që i dallon muslimanët nga të tjerët është kjo dhënie e selamit, që do të thotë: ‘Paqja, mëshira dhe siguria qoftë mbi ju’. Kështu kish për t’u realizuar paqja e

vërtetë në mesin e muslimanëve dhe nuk kish për të pasur armiqësi dhe xhelozë në mes tyre.

Besimtari duhet ta dijë dhe ta përkujtojë vazhdimisht fjalën e Muhamedit a.s. se: ‘Muslimani është vëlla i muslimanit, nuk guxon që t’i bëjë atij zullum (padrejtësi), nuk guxon që atë ta dorëzojë në dorë të armikut, nuk guxon ta poshtërojë atë etj.’ Kjo ide apo ky kuptim ndonjëherë nuk i kujtohet besimtarit, për shkak të ndryshme, mirëpo kur ta përmendë fjalën ‘*es-selamu-alejkum*’ atij i kujtohet ai kuptim i rëndësishëm dhe ajo këshillë e Muhamedit a.s., që e lidh atë me vëllanë e tij musliman, dhe kur edhe ai tjetri e kthen përgjigjen ‘*ve-alejkumus-selam-ve-rahmetullah*’ – ‘po ashtu paqja e Allahut xh.sh. dhe mëshira e Tij qoftë mbi ju’, me këtë përgjigje vërtetohet dashuria në mes të dyve dhe të dyve ju kujtohet hadithi i Muhamedit a.s. dhe kjo konsiderohet si përtëritje e kontratës së paqes në mes të dyve.

Mu për këtë arsye *din*-i islam na ka mësuar që të përsëritet dhënia e selamit sa herë që përsëritet takimi në mes dy besimtarëve. Ja se çfarë thotë Muhamedi a.s. në këtë hadith: ‘*Nëse dikush prej jush e takon vëllanë e tij musliman, le t’i japë atij selam. Edhe nëse e takon pas ndonjë muri a lisi, përsëri le t’i japë atij selam*’. [Transmetuar nga EBU DAVUDI.]

Mu për këtë arsye duhet që muslimani të largohet nga përshëndetjet e jobesimtarëve e t’i kthehet përshëndetjes me të cilën na ka mësuar Allahu xh.sh., në mënyrë që të realizohet lidhja vëllazërore, paqja dhe dashuria në mes nesh.

13- EDUKIMI I FËMIJËVE

Muhamedi a.s. thotë: “Urdhërojini fëmijët tuaj për namaz që nga mosha 7 vjeçare, rrihini ata nëse e lënë namazin që nga mosha 10 vjeçare dhe ndajini shtretërit e tyre gjatë fjetjes”. [E ka transmetuar Imam Ahmedi në musnedin e tij dhe Ebu Daudi në sunenin e tij.]

Ky hadith i Muhamedit a.s. përmban një prej ligjeve kryesore që ka të bëjë me edukimin e fëmijëve, në realitet ky hadith përfshin 3 ligje: 1) urdhërimi i fëmijëve për namaz, 2) rrahja e tyre nëse e lënë atë dhe 3) ndarja e tyre gjatë fjetjes nëpër shtretër. Ky konsiderohet si një obligim i sheriatit për prindërit, obligim për të cilin ata do të pyeten në ditën e gjykimit para Allahut xh.sh. Nëse nuk e kryejnë këtë obligim do të ndëshkohen, nëse e realizojnë do të shpërblehen nga Allahu xh.sh.

Urtësia e kësaj çështjeje qëndron në faktin se Allahu xh.sh. e ka bërë të varur çështjen e të vegjëlvë nga më të mëdhenjtë, nga kujdestarët e tyre, duke filluar nga baba, e kështu me radhë.

Të gjithë ata janë përgjegjës për çdo vepër të keqe që rrjedh nga fëmijët e tyre.

Po ashtu ata do të shpërblehen nga Allahu xh.sh. nëse ua mësojnë fëmijëve ndonjë vepër apo cilësi të mirë.

Përgjegjësia e babait ndaj fëmijëve të tij konsiderohet si përgjegjësia e parë mbi të cilën Allahu xh.sh. e ka ngritur shoqërinë njerëzore.

Tani do mundohemi ta sqarojmë në mënyrë të detajuar urtësinë që qëndron pas këtij ligji.

Kur lindet një fëmijë, dëshira e Allahut xh.sh. ka qenë dhe është që atë fëmijë ta dorëzojë në duart e prindërve të tij me natyrë të pastër. Nëse atë fëmijë kishim për ta lënë në një vend, ku nuk do të kishte ndikime të jashtme në edukimin e tij, ky fëmijë kishte për t’u rritur në rrugën e drejtë dhe të vërtetë, me natyrë të pastër në Islam dhe nuk do të kish qenë e mundur që ai të devijonte, sepse çdo devijim e ka bazën që nga fëmijëria për shkak se fëmijët nuk posedojnë rezistencë dhe forcë për t’u shmangur prej devijimeve. Prandaj nëse kërkojmë që kjo ‘bimë’ të ruhet dhe të shpëtojë nga devijimet duhet t’i kushtohet rëndësi që nga mosha fëmijërore.

Nëse ruhet në këtë periudhë atëherë mbetet i tillë edhe më tej, e nëse jo atëherë mbetet i shtrembëruar dhe mandej përmirësimi është i vështirë. Mu për këtë arsye *din*-i islam i ka kushtuar rëndësi të veçantë edukatës së mirë që nga fazat e para të jetës së fëmijës.

Shtrohet pyetja se: cilës edukatë duhet t’i kushtojmë rëndësi dhe t’i japim përparësi gjatë edukimit? Përgjigjja: Besimit në një Zot. Fëmija duhet të ketë bindje pozitive për ekzistencën që e rrethon, se ajo është krijesë e Allahut xh.sh. Pastaj falja e namazit është një pikënisje e rëndësishme dhe e shëndoshë për të mbjellë vlerat e tjera të moralit në shpirtin dhe sjelljen

e tij dhe kjo konsiderohet si një ushqim i posaçëm i shpirtit dhe natyrës së pastër për personalitetin e tij islam, pasi namazi i përfshin të gjitha parimet e larta njerëzore.

Nuk ka dyshim aspak se interesimi dhe kujdesi i prindit duhet të jetë më tepër rreth namazit dhe edukimi nuk mund të japë efektin e tij të duhur nëse nuk bazohet në dy baza të shëndosha: dëshirën dhe frikën. Obligimi ynë është që të fillojmë me bazën e parë, dëshirën dhe vullnetin. Nëse kjo e para nuk ka sukses dhe nuk ndikon fare, dhe fëmija është i rritur dhe e kupton frikën, atëherë i kthehemi përdorimit të metodës së dytë, frikës. Është gabim i madh të përdoret metoda e butësisë me fëmijët në çështjet fetare, sepse dëshira për namaz nuk është gjithmonë prezent te fëmijët, pasi është vështirë që t'ju rrihet gati namazeve në kohë të caktuar. Edhe nëse tenton që fëmijës t'i japësh ndonjë shpërblim për faljen e çdo namazi, ai do të mundohet që të kryejë obligimin me qëllim që ta arrijë shpërblimin e caktuar.

Po ashtu është gabim kur dikush thotë se fëmija tani duhet lënë i qetë dhe se në të ardhmen koha do ta edukojë vetvetiu. Në këtë mënyrë lihet anash edukimi i tij dhe kur fëmija rritet arrin moshën e pubertetit (e pjekurisë) atëherë është vështirë për prindin apo edukuesin që ta edukojë këtë fëmijë.

Po ashtu, ky prind nuk do të ketë arsye të ankohet tek Allahu xh.sh. për mosdëgjimin e djalit të tij kur ai të jetë rritur, sepse Allahu xh.sh. nuk e ka obliguar atëherë edukimin e tij. Kur të jetë rritur, ai është në gjendje të diskutojë dhe të japë mendime të reja, dhe do jetë barazuar me prindin e tij në trup dhe në forcë.

Allahu xh.sh. ia ka dorëzuar këtë fëmijë prindit kur ai ishte i mitur, kur prindi ishte në gjendje që ky fëmijë t'ia pranonte këshillën, të merrte edukatën e duhur dhe të pranonte çdo përmirësim, përderisa ishte në natyrën e tij të pastër.

Me të vërtetë, fëmija është amaneti më i shtrenjtë që Allahu xh.sh. ia ka dorëzuar në dorë prindit, prandaj llogaria në ditën e gjykimit për humbjen e atij amaneti do të jetë tepër e vështirë dhe e rëndë.

14- BARAZIA NË DHËNIE NDAJ FËMIJËVE

Nuemani, i biri Beshirit, transmeton se babai i tij, Beshiri, shkoi te Muhamedi a.s. dhe i tha: *-Këtij djalit tim unë ia dhashë (dhurova) një shërbëtor timin. Muhamedi a.s. i tha: - A u ke dhënë të gjithë fëmijëve njësoj si këtij? Beshiri tha: Jo. Atëherë Muhamedi a.s. tha: -Merrja përsëri shërbëtorin (d.m.th: kjo nuk është barazi dhe drejtësi ne mes fëmijëve).* [E kanë transmetuar: **Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi, Nesaiu dhe Tirmidhiu.**]

Me këtë hadith, Muhamedi a.s. e ndaloi që prindi, gjatë dhënies së pasurisë fëmijëve të vet në shenjë dhurate, disa t'i veçojë e t'u japë më tepër, ndërsa të tjerëve jo. Të gjithë duhet të marrin të njëjtën sasi të pasurisë.

Dijetarët islamë, në lidhje me këtë çështje, janë në dy mendime: Disa thonë se kjo vepër është haram (e ndaluar), ndërsa disa thonë se është mekruh (jo e preferuar, jo e pëlqyer) dhe askush prej dijetarëve nuk është i pajtimit që kjo vepër lejohet, sepse hadithi është i qartë në këtë aspekt. Mirëpo nëse të tjerët (vëllezërit e tij) pajtohen me një gjë të tillë, pra që prindi i tyre e ka veçuar njërin prej vëllezërve, atëherë kjo vepër lejohet.

Sa i përket urtësisë që gjendet në këtë ligj pejgamberik, ajo është e qartë dhe e dukshme në këto pika: prindi e ka për obligim që dashurinë, mëshirën dhe pasurinë e tij, ta ndajë me drejtësi dhe saktësi në mes të fëmijëve të tij, pa e dalluar asnjërin prej tyre në lidhje me ato që u përmendën.

Nëse nuk realizohet ky parim islam gjatë edukimit të fëmijëve, çdo gjë është e kotë.

Nëse dallimi i fëmijëve në dashuri shkakton probleme dhe xhelozë në mes tyre, atëherë dallimi dhe veçimi i tyre në dhënien e pasurisë shkakton pasoja akoma më të rënda në mesin e fëmijëve kur ata rriten dhe bëhen burra.

Din-i islam i ka kushtuar rëndësi të madhe rehatisë dhe harmonisë në familje, prandaj edhe na tërheq së tepërmi vërejtjen rreth realizimit të dashurisë, mirëkuptimit dhe sigurisë në mes të anëtarëve të familjes.

Shoqëria njerëzore është si një pasqyrë që reflekton rrezet e familjeve, p.sh. përhapja e dashurisë dhe drejtësisë në shoqëri është argument i fortë që na bën të ditur se edhe nëpër familje po praktikohet drejtësia dhe, anasjelltas, përhapja e xhelozisë, e hidhërimit dhe armiqësisë në shoqëri është argument që na bën të ditur se po në atë gjendje janë edhe familjet. Sa herë që dikush nga anëtarët e familjes shtypet dhe i bëhet padrejtësi, ai në atë moment nuk mundet ta ndalë hakmarrjen e tij në familje, prandaj i kthehet shoqërisë së pastër dhe i hakmerret asaj.

Humbja e përgjegjesisë në familje dhe padrejtësia në mes anëtarëve të saj është shkaku më kryesor për padrejtësinë që shfaqet në shoqëri.

Për këtë arsye *din*-i islam na ka obliguar që të jemi korrekt (të drejtë) ndaj fëmijëve, gjatë kujdesit tonë ndaj tyre, gjatë dhënies etj., përderisa të gjithë fëmijët (vajzat dhe djemtë) janë të sjellshëm ndaj prindërve dhe i respektojnë ata. Ndoshta dikush mund të pyesë: Kur njeriu është i lirë që pasurinë e tij t'ia japë edhe një të huaji, atëherë a nuk ka të drejtë ai që tërë pasurinë e tij t'ia japë fëmijës së vet? Përgjigjja është se ekziston një dallimi i dukshëm në mes dy krahasimeve. Lidhjet shpirtërore që ekzistojnë në mes tyre nuk janë të barabarta. Ti mundesh që pasurinë tënde t'ia dhurosh dikujt tjetër (një muslimani) e mandej mos të të interesojë fare çështja e tij. Ndoshta edhe nuk e sheh atë më kurrë. Mirëpo te fëmijët e tu ndryshojnë raportet. Ti çdo ditë je me ta, prandaj çdo dallim i yti ndaj atyre ndikon negativisht në mesin e tyre, përderisa të gjithë ata janë të respektueshëm ndaj teje.

E nëse ata nuk janë të respektueshëm ndaj prindërve të tyre, kjo është një çështje krejt tjetër. Edhe gjatë shërimit të këtij problemi duhet të jemi të kujdesshëm. Ndoshta, në këtë rast, pasuria luan rolin kryesor në përmirësimin e këtij personi. Nëse ai nuk është i dëgjueshëm atëherë pranohet që atij t'ia ndalim pasurinë, se ndoshta përmirësohet dhe kthehet. Po nëse përsëri nuk është i dëgjueshëm, atëherë provojmë që atë ta përmirësojmë me dhënien e pasurisë. Ai me të keqe e ti me të mirë, e nuk ka qare pa triumfuar (fituar) e mira.

15- FEJA DHE AMANETI

Muhamedi a.s. ka thënë: *“Nuk e ka besimin e plotë ai i cili nuk ka amanet (frikë nga Allahu xh.sh. për të realizuar diçka) dhe nuk ka fe të plotë e të përsosur ai i cili nuk ka besë.”* [E transmeton Ahmedi, Bejhekiu dhe Ibni Hibani.]

Amaneti dhe besa janë dy cilësi të pandashme nga njëra-tjetra. Kur është prezent amaneti (frika e Allahut xh.sh. për të realizuar çështjen që të është besuar), atëherë edhe realizimi i tij kryhet në mënyrën e duhur dhe njeriu, kur qëndron stabil në fjalët dhe veprat e tij, fiton titullin i besueshëm (apo besnik).

Amaneti dhe besa konsiderohen prej vlerave më të larta dhe më të shtrenjta në jetën e muslimanit dhe prej obligimeve kryesore pas besimit në Allahun xh.sh.

Urtësia dhe shkaku obligativ i këtij parimi qëndron në faktin se Allahu xh.sh. i ka obliguar robërit e tij me besim ndaj Tij dhe besimi në Allahun xh.sh. kërkon bindje për ditën e gjykimit, për xhenetin, për xhehenemin, me qëllim që ne të jemi të kujdesshëm ndaj punëve dhe veprave që veprojmë, sepse Allahu xh.sh. është mbikëqyrës për çdo vepër që punohet dhe Ai do ta shpërblejë të mirën me të mirë dhe të keqen me të keq. E kur muslimani e kupton kështoj jetën e tij, atëherë ai mund të përmirësohet dhe të largohet nga çdo dredhi dhe padrejtësi.

Nëse dikush deklaron para dikujt se beson tek Allahu xh.sh. dhe dita e gjykimit, e në anën tjetër i tradhton dhe i pret në besë të tjerët, ky lloj i tipit njerëzor është në kundërshtim me vetveten dhe nuk është aspak real, për arsye se po të ishte besimtar i sinqertë ai kishte për ta ndier përgjegjësinë dhe frikën ndaj Allahut xh.sh. dhe nuk kishte për t'i tradhtuar dhe gënjyer të tjerët.

Ai i cili e përhap një fshehtësi të vëllait të tij, ose frikësohet nga ai që të ketë ndonjë marrëdhënie me të, ose frikësohet që t'ia besojë atij një sasi të pasurisë, ose frikësohet që të konsultohet me të për josingëritetin që ka, ai në realitet nuk është besimtar i vërtetë.

Çfarë dobie ka të paraqitemi formalisht si besimtar para dikujt e të ngremë tespitë duke thënë ‘elhamdulillah’, ‘subhanalla’, e t'i ngremë minaret e xhamive lart, e në anën tjetër të mos jemi të besueshëm e të sinqertë ndaj njëri-tjetrit dhe të mos e kemi frikën e Allahut xh.sh. në zemrat tona?

Qëllimi i fesë është që t'iu sigurojë njerëzve një rrugë të sigurt, që do t'u siguronte atyre kënaqësinë individuale dhe shoqërore. Ai i cili përqendrohet dhe i zbaton formalisht parimet fetare nuk ka për të korrur asesi sukses, prandaj si do të jetë përfundimi i një shoqërie e cila e ka humbur besën dhe amanetin?

Përfundimi është shkatërrim: në bisedat e tyre, në këshillat dhe tregtitë e tyre humbet besimi ndaj njeri-tjetrit.

Nuk mund t'i shohësh bashkërisht dhjetë persona që të organizohen në mes vete për të ndërmarrë ndonjë aksion, e nuk kalojnë veçse disa ditë dhe do të shohësh se njëri prej tyre ka dalë tradhtar, ky tjetri spiun, tjetri hipokrit etj. Në vend se të bashkohen, të vëllazërohen në mes vete, të jenë të sigurt dhe t'i përmbushin zemrat e tyre përplot dashuri, ata i mbushin përplot tradhti dhe zili ndaj njëri-tjetrit.

Mu për këtë arsye, për t'u kthyer besa dhe amaneti në zemrat e popullit, duhet që të sigurohet besimi i vërtetë dhe i sinqertë.

Këtë çështje të rëndësishme do ta ilustrojmë me një rast nga historia e gjeneratës së hershme (selefus – salih), ku shihet imani dhe frika e tyre nga Allahu xh.sh.

Muhamed ibni Munkedir ka qenë tregtar i sinqertë në profesionin e tij.

Ai kishte pasur një shërbëtor që i ndihmonte atij gjatë tregtisë. Njëherë shërbëtori i tij kishte shitur diçka më shtrenjtë se sa çmimi origjinal i mallit. Muhamedi s'kishte qenë aty prezent dhe blerësi kishte shkuar. Kur Muhamedi (zotëria i tij) e mori vesh se shërbëtori e kishte shitur artikullin më shtrenjtë se sa çmimi i duhur, ai doli në treg dhe e kërkoi blerësin me qëllim që t'ia kthente atij tepricën e çmimit që ia kishte marrë shërbëtori i tij. Kush e ka shtyrë Muhamedin, këtë tregtar të sinqertë, që të dalë në treg dhe ta kërkojë blerësin me qëllim që t'ia kthente tepricën, përveç imanit, sinqeritetit dhe besës së tij ndaj popullit dhe ndaj Allahut xh.sh.?

Po ashtu, edhe hulefai rashidinët (sunduesit e drejtë e të udhëzuar) e të tjerët kanë qenë besimtarë të sinqertë e të devotshëm në punën dhe përgjegjësinë e tyre, e për këtë arsye është realizuar qetësia, siguria dhe vëllazëria në mes njerëzve. Prandaj nuk duhet të çuditemi pse Muhamedi a.s. ka thënë: *“Nuk ka besim ai i cili nuk ka amanet dhe nuk ka fe ai i cili nuk ka besë”*.

16- PËR PRAKTIKIMIN E LIGJEVE FETARE KËRKOHEM BUTËSI DHE GRADUALITET

Muhamedi a.s. ka thënë: *“Me të vërtetë, në praktikimin e parimeve të fesë ka vështirësi, prandaj mundohu për t’i praktikuar ato gradualisht dhe dalëngadalë, pasi ai që e mundon mjetin për të arritur te caku, e shkatërrohet (dëmton) mjetin dhe nuk e arrin cakun.”* [Transmeton imam Ahmedi nga hadithi i Enesit, dhe Bejhekiu nga hadithi i Xhabirit.]

Muhamedi a.s., me këtë hadith, na tregon një ligj (parim) islam tejet të rëndësishëm. Ai na tregon se feja islame është e gjerë dhe plot me parime, e kush tenton që të ngutet për t’i realizuar këto ligje dhe parime, nuk mundet, sepse rruga është e gjatë dhe forca e tij e vogël, e ndoshta ky person shkatërrohet tërësisht në atë rrugë të gjatë për shkak të forcës së vogël që ka. Pikërisht për këtë arsye është vaxhib (obligim) që muslimani t’i marrë dhe t’i praktikojë ligjet fetare gradualisht dhe pa u ngutur fare. Muhamedi a.s. na e ilustron këtë çështje të rëndësishme me një shembull shumë adekuat, duke thënë: Ai i cili mundohet që t’i praktikojë tërësisht dhe menjëherë parimet e fesë islame, është sikurse një njeri i cili mundohet të kalojë një pjesë të rrugës duke e munduar pa mëshirë mjetin e tij bartës. Çka do të ndodhë me këtë njeri? Mjeti do t’i shkatërrohet para kohe dhe ai do të ngelet në gjysmë të rrugës. A është kjo mençuri? Natyrisht jo!

Ky ligj islam konsiderohet si një rregullore edukative – arsimore tejet e rëndësishme, të cilën duhet ta dijë dhe kuptojë çdo musliman, për arsye se praktikimi i obligimeve të fesë islame përmban një lloj vështirësie për trupin dhe epshin e njeriut. E prej muslimanit kërkohet vazhdimisht rishikimi i këtyre dy elementeve (trupit dhe epshit). Kështu që, në mënyrë graduale, ligjet e fesë islame realizohen pa problem dhe njeriu nuk duhet që t’i stërngarkojë këto të dyja, me të gjitha ngarkesat e fesë, menjëherë. Është një bindje e gabuar të disa persona (hoxhallarë apo të tjerë) kur thonë se Allahu xh.sh. ka kërkuar nga robërit e Tij që ata t’i besojnë në një mënyrë apo në një metodë që përmban në vetvete vështirësi dhe mundim. Të këtij mendimi janë pjesa dërrmuese e dijetarëve të fesë islame.

Ai i cili mundohet t’i realizojë gradualisht ligjet e fesë islame do t’i sigurojë vetes një jetë të lumtur. Argument për çështjen në fjalë kemi rastin e Muhamedit a.s. Praktikimi i fesë islame u plotësua gradualisht për 23 vite. Allahu xh.sh. kishte mundur ta plotësonte predikimin e fesë edhe për një kohë shumë më të shkurtër, mirëpo Ai e zgjodhi këtë metodë për t’i dhënë botës mësim dhe udhëzim se në çështjet fetare kërkohet gradualitet dhe ngadalësim, me qëllim që fjala të ketë sukses. Ai i cili vepron kështu i siguron vetes siguri dhe përparim gjithnjë, dhe nuk kthehet kurrë mbrapa. Ekzistojnë shembuj të disa personave të cilët i kanë

marrë çështjet e fesë me vrull dhe me shpejtësi, mirëpo pas pake kohësh i kanë lënë të gjitha obligimet fetare, bile edhe ato më kryesoret, sepse janë dobësuar (lodhur) dhe nuk kanë pasur forcë që t'i përballojnë të gjitha ligjet e fesë islame, e si rezultat i kësaj ata kanë stagnuar krejtësisht. Mu për këtë arsye Muhamedi a.s. ka thënë: *“Me të vërtetë kjo fe është e lehtë, nëse dikush tenton ta mundë atë, ai do të humbë”* (që do të thotë se nëse ti mundohesh me tërë forcën tënde që t'i praktikosh ligjet dhe parimet e fesë, atëherë nuk do të mundesh). Është gabim fatal i shumë prindërve dhe mësuesve që i stërngarkojnë dhe i detyrojnë fëmijët dhe nxënësit e tyre me dhunë që t'i praktikojnë ligjet e fesë. Kjo metodë ka qenë e dështuar dhe jo e suksesshme. Si pasojë e kësaj dhune të pamëshirshme ata fëmijë ose nxënës janë bërë më të pasjellshëm.

Kemi parë shumë djelmosha të rinj besimtarë, të cilët i kanë bërë Allahut xh.sh. ibadet tërë natën duke falur namaz nafile, pastaj ata e kanë lënë namazin nafile, plus i kanë lënë edhe farzet.

E tërë kjo që u tha nuk do të thotë që të bëjmë lehtësime të panevojshme aty ku nuk duhet, mirëpo edhe nuk duhet të bëjmë ngarkim të tepërt, por duhet të gjejmë një pikë mesatare në mes të lehtësimit dhe ngarkimit. Shejtani mundohet që ta hutojë muslimanin në mes këtyre dy pikave të rëndësishme dhe ta dezorientojë atë, prandaj kërkohet dituria islame që muslimani të ruajë veten e tij nga çorientimet.

17- MUSLIMANI NUK GUXON TA POSHTËRSOJË VËLLANË E TIJ MUSLIMAN

Muhamedi a.s. ka thënë: “*Për muslimanin (besimtarin) është mëkat që ai ta nënçmojë vëllanë e tij musliman.*” [E transmeton Imam Muslimi prej hadithit të Ebu Hurejres]

Në këtë hadith të Muhamedit a.s. shihet dukshëm ndalesa e rreptë e nënçmimit të muslimanit nga vëllai i tij musliman, me të gjitha ngjyrat e nënçmimit.

Nocioni EL – IHTIKAR do të thotë: ‘poshtërim’, ‘nënçmim’ dhe ky nënçmim nuk lejohet kurrë, pa marrë parasysh shkaqet dhe motivacionet. Ndërsa nocioni EL – INTIKAD ose EN – NEKDU do të thotë: të jesh kritik ndaj dikujt prej dy aspekteve: pozitiv dhe negativ, dhe kjo lejohet në rrethana të caktuara dhe për qëllime të caktuara.

NAKDI – bëhet ndaj dikujt kur ai person e lë mangët ndonjë vepër ose gabon në të. Kjo konsiderohet si kontrollim i veprave dhe plotësim i mungesave.

Ndërsa EL – IHTIKAR do të thotë: nënçmim dhe ulje të personalitetit të dikujt, duke i përjashtuar punët dhe fjalët e tij.

Nëse e ke kuptuar dallimin në mes këtyre dy termave, edhe pse është tejet e vështirë të dallohet dallimi në mes tyre dhe janë të paktë ata të cilët i kuptojnë ato, atëherë shihet dukshëm shkakun dhe mençuria e kësaj ndalese, në të gjitha emrat dhe llojet që ka.

Nënçmimi i të tjerëve ka si pasojë shkatërrimin e individit dhe shoqërisë, dhe nuk sjell asnjë dobi individuale e as shoqërore.

Ndërmjet nënçmimit përhapen farat e xhelozisë, hidhërimit, shkatërrimit dhe tradhtisë në shoqëri.

Ai i cili ua dëshiron të mirën të tjerëve i këshillon ata në mënyrë islame dhe vëllazërore, dhe kjo është më e lehtë dhe më e mirëseardhur për të dhe për shoqërinë. Ata të cilët e kanë zakon që t’i përqeshin dhe t’i nënçmojnë të tjerët, gjithmonë tentojnë që t’ua gjejnë të tjerëve të metat dhe anët negative, pa i parë asnjëherë anët pozitive të tyre. Kjo sjellje konsiderohet tejet e rrezikshme, sepse atyre nuk iu pëlqen askush, si në fjalë ashtu dhe në vepër.

Përbërja e njeriut (përveç peygamberëve të Allahut xh.sh.) është e përzier me dobësi dhe plotësime, e një prej dobësive është kritika e tij ndaj të tjerëve. Mirëpo kritika, nëse është me vend dhe e qëlluar, është e mirëseardhur, ndërsa nëse kritika është për vetë qenien e njeriut dhe urrejtje personale ndaj tij, kjo me të vërtetë nuk lejohet dhe nuk ka aspak logjikë dhe bazë të shëndoshë. Ku gjendet rrugëdalja nga kjo krizë e rrezikshme dhe çfarë ilaçi duhet përdorur që personi të shërohet nga kjo sëmundje e rëndë?

Shërimi dhe zgjidhja e këtij problemi qëndron te vetë personi. Ai duhet të ndalet tek vetja e tij e të logjikojë për të metat e tij. E nëse është i mençur dhe i sigurtë, do të shohë se edhe ai vetë është i mbushur plot me të meta dhe sjellje të këqija dhe se nuk është hiç më i pastër se ata. Prandaj ai duhet të fillojë gradualisht me përmirësimin e vetes së tij dhe duhet të përdorë metodat dhe forcat maksimale për përmirësim e vetvetes, e në fund kur të shohë se, mbas tërë atij angazhimi për përmirësim, ende është i përlyer me të meta, atëherë le ta dijë se kjo dukuri (dobësia e njeriut i cili i kritikon të tjerët dhe e harron vetveten) është vepër e Allahut xh.sh. i Cili e ka krijuar njeriun dhe ka bërë që dobësia të jetë pjesë e natyrës së njeriut. Njeriu është i dobët prej natyrës së tij dhe kjo dobësi duhet të jetë shkak që ai njeri t'i mbyllë sytë dhe gojën nga kritikrat e të tjerëve sepse edhe ai vetë është sikurse ata.

Megjithatë, përveç këtyre që u thanë deri më tani, sheriati islam nuk na ka lënë neve që të jemi të lirë e të kënaqemi me gjestet e këqija dhe sjelljet jo islame të njeri-tjetrit, e të ndalemi nga këshillat dhe udhëzimet e njëri-tjetrit. Ne duhet që ta ndihmojmë njeri-tjetrit, që të ngrihemi në një shkallë më të lartë të moralit dhe të plotësisimit, duke e këshilluar njëri-tjetrin me durim dhe në rrugë të vërtetë.

Madje këshilla dhe udhëzimi në rrugën e Allahut xh.sh. (fisebililah) kërkohet dhe preferohet. Për këtë Muhamedi a.s. thotë: *“Feja është këshillë – nasihat.”*

Ndërsa urrejtja dhe nënçmimi i të tjerëve ndalohet rreptësisht dhe duhen shmangur menjëherë. Për këtë Muhamedi a.s. thotë: *“Është mëkat për muslimanin që ai ta urrejë dhe poshtërojë vëllanë e tij musliman”*.

18- NJË PREJ MËNYRAVE TË MIRËSISË NDAJ PRINDËRVE

Muhamedi a.s. ka thënë: “*Është mirësi që njeriu të sillet mirë me shokët e babait të tij edhe mbas vdekjes së tij.*” [Transmeton Imam Muslimi, Tirmidhiu dhe Ebu Davudi nga hadithi i Ibni Ymerit.]

Në këtë hadith Muhamedi a.s. na sqaron se një prej mirësive më të dukshme të fëmijës ndaj babait të tij është që ai të vazhdojë t’i nderojë shokët e babait të tij kur ai ishte gjallë, t’i vizitojë ata, të sillet mirë ndaj tyre dhe t’i ripërtërijë sjelljet e babait të tij me ta.

Pa dyshim, sipas mendimit të të gjithë dijetarëve islamë, kjo vepër konsiderohet si një prej ibadeteve më të mira tek Allahu xh.sh. Kjo mirësi, për të cilën fton Muhamedi a.s., ka efekt të lartë shoqëror. Ndoshta pjesa dërmuese nuk mundet ta hetojë këtë efekt pa e lexuar këtë hadith të Muhamedit a.s. Ne mund të hymë dhe të komentojmë më gjerësisht për detajet e këtij problemi:

Prej detyrave më të rëndësishme, që Allahu xh.sh. ua ka ngarkuar robërve të Tij, është që ata të jenë të udhëzuar dhe të afruar në mes vete dhe t’i largojnë shkaqet e ndarjes dhe të hidhërimit. Më i miri në këtë jetë konsiderohet ai i cili largohet nga hidhërimi dhe ndarja, ndërsa më i keqi konsiderohet ai i cili, mbas vdekjes së tij, i lë gjurmët e fitnes dhe të fesadit. Fëmijë i mirë (besimtar) është ai i cili kërkon kënaqësinë e Allahut xh.sh. duke u sjellë mirë me prindërit e tij dhe, për këtë arsye, Allahu xh.sh. e ka bërë atë si zëvendësuesin e parë të besueshëm, i cili mundohet t’i realizojë të gjitha kërkesat e prindit, si gjatë jetës së tij ashtu edhe pas vdekjes së tij. Fëmija konsiderohet si vazhdim i mirësisë që e kanë lënë trashëgimi prindërit i tij mbas vdekjes.

Prej mirësisë që ka lënë babai mbas vdekjes së tij është edhe vazhdimi, nga ana e djalit të tij, i marrëdhënieve njerëzore që ai i ka pasur me vëllezërit dhe shokët e tij, duke iu ndihmuar atyre, duke i këshilluar ata dhe duke i forcuar lidhjet vëllazërore në emër të Allahut xh.sh.

Bashkimi i disa vëllezërve muslimanë, në emër të Allahut xh.sh., konsiderohet si një vepër madhështore për ngritjen e vëllazërimit islam në mes robërve të Allahut xh.sh. mbi tokë. Mbas vdekjes së prindit, fëmija i tij trashëgon një ndërtesë të mirë e të bukur. Ai është i mirë, i sjellshëm dhe besnik ndaj kësaj ndërtese, prandaj për hir të prindërve të tij, atij i takon ta vazhdojë shoqërinë e prindërve dhe ta ruajë që të mos shkëputet e të humbasë.

Në këtë mënyrë zhvillohen, rriten, zgjerohen dhe përforcohen rrënjët e dashurisë dhe mirëkuptimit në mes njerëzve. Gjenerata e fundit e ruan atë që ka themeluar gjenerata e parë, e kështu gjeneratë pas gjenerate, derisa të gjithë ta praktikojnë këtë porosi të Muhamedit a.s.

Ekzistojnë shumë lidhje njerëzore, të ndryshme në mes vete, të cilat personat i kanë ruajtur derisa kanë qenë gjallë, mirëpo mbas vdekjes së tyre këto lidhje janë shkëputur dhe janë copëtuar në mes vete, për arsye se mbas tyre nuk ka pasur kush t'i trashëgojë ato sjellje. Ligjet njerëzore njohin vetëm një lloje trashëgimie të fëmijës nga prindërit e vet, trashëgiminë e pasurisë, pra atë të të hollave, të tokës dhe shtëpisë së tij. Mirëpo sheriati i Allahut xh.sh kësaj trashëgimie i ka bashkangjitur një lloj trashëgimie edhe më interesante dhe më kryesore. Ajo është trashëgimia e cilësive dhe vetive të mira të prindit të tij, përveç asaj pasurisë.

Kjo trashëgimi njerëzore nuk bën të këputet me vdekjen e pronarit të parë, por duhet bërë çmos që ajo të mbetet gjallë. Ky ligj i Allahut xh.sh., për të cilin na apelon Muhamedi a.s., nuk do të thotë që fëmija t'i ruajë dhe t'i nderojë shokët e prindërve edhe nëse ata janë jashtë binarit islam – fjalës së Kuranit dhe Muhamedit a.s., mirëpo qëllimi i hadithit është që mirësjellja jonë ndaj shokëve të prindërve të jetë përderisa ata janë me parime islame. Ai i cili trashëgon nga prindi i tij diçka jo të drejtë, për sa i përket moralit, apo pasurisë, apo nëse ai i ka hyrë dikujt në hak, atëherë është obligim i fëmijës që të gjitha këto t'ia nënshtrojë fjalës së Allahut xh.sh. dhe t'i trasojë në udhën e saktë.

19- DUAJA (LUTJA) ËSHTË ZEMRA (TRURI) I IBADETIT NDAJ ALLAHUT XH.SH.

Allahu xh.sh. në Kuranin famëlartë thotë: *“Mos bëni çrregullime në tokë pas rregullimit të saj (me ardhjen e pejgamberëve).”* [El Ae'raf: 56]

Allahu xh.sh., në këtë ajet kur'anor, i urdhëron robërit e tij që ata t'i afrohen Allahut xh.sh. me dua, me dy motivacione dhe dy shkaqe nxitëse: frika prej dënimit të Allahut xh.sh. dhe lutja ose shpresa për të mirat e Allahut xh.sh.

Ky urdhër kur'anor është përsëritur disa herë në Kuran. Allahu xh.sh. thotë: *“Luteni Zotin tuaj të përulur e në heshtje, pse Ai nuk i do ata që e teprojnë.”* [El A'raf: 56.]

Për një grup njerëzish të mirë e të devotshëm, Allahu xh.sh. thotë përsëri: *“Ata përpiqeshin për punë të mira, na luteshin duke shpresuar dhe duke u frikësuar, ishin respektues ndaj Nesh.”* [El Enbija: 90]

Për këtë arsye, dijetarët kanë prurë mendimin e përbashkët [EL-IXHMA] se afrimi në mëshirën e Allahut xh.sh. me anë të duasë (të lutjes) konsiderohet si zemra e ibadetit dhe e fesë, me të cilën muslimani duhet të jetë vazhdimisht i nënshtruar para Allahut xh.sh.

Por qëllimi i duasë nuk duhet të keqkuptohet nga ndokush dhe ai ta konsiderojë duanë (lutjen) si një mjet për t'i realizuar qëllimet e tij personale dhe t'i lutet Allahut xh.sh. për interes, që Ai t'ia sigurojë atij të mirat dhe t'ia largojë të këqijat.

Duhet ditur dhe kuptuar se duaja (lutja) është ibadet (adhurim) më vete. Njeriu me këtë dëshmon dhe tregon robërinë dhe mëshirimimin e tij para madhërisë së Allahut xh.sh., duke mos e çuar mendjen fare nga ajo se a po më pranohet apo jo kjo dua. Ai duhet ta dijë se nuk ka mbështetës tjetër përveç Allahut xh.sh., se nuk ka mbrojtës tjetër përveç Allahut xh.sh., se nuk ka Zot tjetër kujt t'i ankohet përveç Allahut xh.sh. dhe se Krijuesi i tij, në dorën e të cilit është rehatia dhe jorehatia e tij, është Allahu xh.sh.

Prandaj njeriu nuk ka tjetër rrugëdalje por veçse që të kthehet sinqerisht dhe me tërë qenien e tij drejt Allahut xh.sh., duke mos u luhatur fare në këtë çështje.

Kjo është domethënia e robërisë së njeriut para madhërisë së Allahut xh.sh. dhe ky është qëllimi final i krijimit të njeriut: që ai të dëshmojë me gjuhën e tij se është rob i thjeshtë i një krijimi të madh.

Allahu xh.sh. i edukon dhe i mëson robërit e tij, që ata të jenë gjithmonë në këtë cilësi të robërisë, për dy shkaqe nxitëse: shpresën në mëshirën e Allahut xh.sh. dhe frikën nga dënimi i Allahut xh.sh.

Besimtari mund t'i vërejë këto dy cilësi edhe në fjalën e Allahut xh.sh.: sa herë që përmendet njëra, menjëherë përmendet edhe tjetra. Po të ishte përmendur vetëm shpresa në mëshirën e Allahut xh.sh., njeriu ndoshta

kishte për të kërkuar diçka që nuk i takon atij dhe, anasjelltas, po të ishte përmendur vetëm frika prej dënimit të Allahut xh.sh., njeriu kishte për t'u bërë pesimist (do t'i humbiste shpresat krejtësisht), e si rezultat nuk kishte për t'u përmirësuar fare.

Robi, nëse dëshiron që të jetë udhëzuar dhe i përforcuar në rrugën e Allahut xh.sh., duhet që paralelisht të jetë me shpresë se Allahu xh.sh. inshalla do ta mëshirojë dhe do ta futë atë në xhenetin e tij dhe, po ashtu, të ketë frikë prej dënimit të Allahut xh.sh. se mos Ai e dënon për ndonjë mosplotësim të obligimeve ndaj Tij. Pikërisht, për këtë arsye, në Kuranin famëlartë nuk mund të gjesh asnjë ajet të rahmetit (mëshirës) pa u përmendur bashkë me të edhe ajeti i dënimit. Çdokund ku Allahu xh.sh. e cilëson Vetën e Tij si mëshirues, menjëherë e cilëson edhe si ndëshkues. Sa për ilustrim po përmendim disa ajete që kanë lidhje me tematikën në fjalë. Allahu xh.sh. thotë: *“Njoftoi robërit e Mi se vërtet Unë jam Ai që fal shumë dhe mëshirues i madh, po (njoftoi) se edhe dënimi Im është ai dënimi i dhimbshëm.”* [El Hijr: 49-50]

Allahu xh.sh. thotë përsëri: *“Thuaj: ‘O robërit e Mi të cilët e keni ngarkuar veten tuaj me shumë gabime, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut xh.sh., pse vërtet Allahu xh.sh. i fal të gjitha mëkatet, Ai është që shumë fal dhe është mëshirues. Dhe kthehuni te Zoti juaj dhe përruluni atij para se t'u vijë dënimi, se pastaj nuk do të ketë kush t'ju ndihmojë.”* [Ez Zumer:53-54]

Kurani famëlartë i cilëson ata të cilët e kanë fituar xhenetin e Allahut xh.sh. me cilësitë më të larta dhe më të mira. Allahu xh.sh. thotë: *“Dhe në syfyr (kohën e mbarimit të natës) ata kërkonin falje për mëkatet.”* [Edh-Dhariatë : 17 – 18] *“Dhe në pasurinë e tyre ka një të drejtë lypësi dhe i ngrati (që ka nevojë dhe nuk lyp).”* [Edh Dhariatë : 19]. Kur i dëgjon këto fjalë ti thua se: unë jam larg prej tyre.

Po ashtu edhe anasjelltas, ata të cilët e kanë merituar dënimin e Allahut xh.sh. në xhehenem, Kur'ani i përshkruan me cilësitë e tyre më të këqija. Allahu xh.sh. thotë: *“Çka ju solli juve në sekar (xhehenem)? Ata thonë: ne nuk kemi qenë prej atyre që faleshim (që bënim namaz), nuk kemi qenë që i ushqenim të varfrit dhe kemi qenë që përziheshim me të tjerët në punë të kota, dhe kemi qenë që nuk besonim në ditën e gjykimit.....”* [El Mud-deth-thir: 42 – 46].

Kur i dëgjon këto ajete, pa dyshim se ti thua: unë nuk jam si ata, ndoshta jam më i mirë. Dhe kështu e sheh veten mes një gjendjeje mesatare: se as nuk je në shkallën e lartë të atyre të mirëve, po edhe nuk je në shkallën e ulët të atyre të këqijve, prandaj zemrën tënde e përshkon frika prej dënimit të Allahut xh.sh. dhe shpresa se Ai do t'i falë mëkatet. Nga ky proces lind robëria e vërtetë ndaj Allahut xh.sh. dhe, në këtë mënyrë, ky proces bëhet shkak nxitës që ti t'i shtrish duart e tua lart përpjetë para mëshirës së Allahut xh.sh. dhe të kërkosh ndihmë nga Ai.

20- EDUKATA PËR URDHËRESËN NË TË MIRË DHE NDALIMIN NGA E KEQJA

Allahu xh.sh. në Kuranin famëlartë thotë: *“Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët) pos Allahut xh.sh., e si (hakmarrje) të fyejnë Allahun xh.sh. nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij). Ne i kemi zbukuruar çdo populli veprimin e vet, mandej e ardhmja e tyre është te Zoti i tyre e Ai i shpërblen për atë që veprojnë”*. [El E'rafë:108]

Ligji që përmban ky ajet është shumë i rëndësishëm. Ai ka të bëjë me një çështje shumë aktuale për misionarin, i cili i thërret njerëzit në rrugën e Allahut xh.sh. dhe mundohet t'i ndalojë ata nga e keqja. Nëse ndonjë ndalesë bëhet shkak për të ndodhur ndonjë problem akoma më i madh, këtij misionari i thuhet mos vepro kësisoj, sepse nuk bën që një problem i vogël të shkaktojë një problem më të madh, fjala vjen: që besimtari t'i shajë zotët e jobesimtarëve, e ata mandej ta shajnë Allahun xh.sh. nga armiqësia e paditura.

Kjo vepër, që shkakton këtë problem më të madh, nuk konsiderohet si urdhëresë në të mirë dhe ndalesë nga e keqja, por konsiderohet si shkak për të rënë në haram më të madh, e Allahu xh.sh. na ka obliguar që ne t'i mbyllim shtigjet të cilat na shpien në haram.

Sa i përket shkakut dhe urtësisë së kësaj ndalesë, këto janë të qarta dhe të dukshme.

Shkaku dhe qëllimi i urdhëresës në të mirë dhe ndalesës nga e keqja është përhapja e hakut (së vërtetës) dhe largimi apo eliminimi e së shtrembrës, sipas mundësive dhe kjo realizohet me anë të këshillës në emër të Allahut xh.sh., duke qenë të qetë e të pastër shpirtërisht nga të gjitha mendimet dhe epshet e këqija, duke dialoguar në mënyrë të kulturuar, si edhe duke u larguar nga ofendimet personale...

Në këtë rast, si u tha më lart, kërkohet urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja për të gjithë besimtarët, ndërsa në rastet e tjera kjo vepër konsiderohet si një prej veprave që Allahu xh.sh nuk e pëlqen.

Prandaj, pikërisht për këtë arsye, duhet ta kemi shumë në konsideratë edukatën, sjelljen dhe mënyrën e eliminimit dhe të largimit të keqes. Mos sjellja mirë dhe mos aplikimi i kësaj edukate, që është kushti paraprak për ndalimin nga e keqja dhe urdhërimin në të mirë, konsiderohet mëkat tek Allahu xh.sh.

Kur një njeri e sheh një të keqe në rrugë dhe nuk është edukuar për ta larguar atë dhe, për shkak të këtij gjesti (pra për shkak të mos ndalimit të tij nga ajo e keqe), personi i cili është duke e kryer atë vepër të keqe zhytet akoma më shumë në atë vepër të keqe, mëkatën e këtij harami e merr ky njeri (personi që nuk e ndaloi e jo vepruesi i keqes).

Në këtë rast është me shumë rëndësi të theksohet dhe të bëhet dallimi prej hidhërimit dhe kritikës për hir të Allahut xh.sh. dhe në emër të Tij dhe hidhërimit me dikë për interesa personale dhe fitimprurëse.

Janë të shumtë ata të cilët i bëjnë kritikën apo mundohen ta largojnë të keqen prej dikujt, jo në emër të Allahut xh.sh., por vetëm për t'u lavdëruar para dikujt ose që atyre t'u thuhet se janë persona të cilët urdhërojnë në të mirë dhe ndalojnë prej të keqes. Kjo është një dukuri që diktohet menjëherë nga pala tjetër dhe ky person, kur e kupton se ai tjetri nuk e ka në emër të Allahut xh.sh., fillon menjëherë të xhelozojë dhe të jetë akoma më këmbëngulës në mëkatën e tij dhe nuk dëshiron të dëgjojë fare.

Sa profesorë e mësues shohin prej nxënësve të tyre ndonjë vepër të keqe që ata e punojnë para tyre, e prej xhelozisë se mos iu humbet autoriteti i tyre 'se kush jemi ne' e 'si guxon ky nxënës apo student ta veprojë këtë turp para nesh', këta kinse po e urrejnë këtë të keqe në emër të dinit dhe të Allahut xh.sh. sillen në mënyrën më brutale dhe më agresive ndaj nxënësve duke i rrahur ata dhe duke i ofenduar, e pastaj ata (nxënësit) në shenjë hakmarrje ndaj profesorëve bëhen edhe më kokëfortë dhe më këmbëngulës në atë vepër të keqe.

Sa hoxhallarë, me uniformë fetare, i shohin të tjerët duke ngrënë haptazi nëpër rrugë gjatë muajit ramazan dhe ky haram bëhet qëllimisht para tyre pse këta janë hoxhallarë me shall, e këtyre hoxhallarëve iu vlon barku prej xhelozisë dhe inatit pse bash para tyre të tjerët po hanë apo po pinë diçka gjatë ramazanit.

Këto lloj qëllimesh të këqija të misionarëve të fesë në veçanti dhe të muslimanëve në përgjithësi nuk na çojnë në përparim.

Muslimani i sinqertë dhe i drejtë kur e ndien veten se nuk është i sinqertë 100%, si në fjalë ashtu edhe në vepër, për një punë që do ta ndërmarë, atëherë për të është më mirë të ndalet ose të heshtë, e nëse e ndien veten të pastër dhe të sinqertë atëherë le të vazhdojë aksionin e tij për fenë islame, në emër të Allahut xh.sh.

Ajeti i lartpërmendur dhe shumë ajete të tjera të ngjashme si ky iu kanë mundësuar dijetarëve të fesë islame, sidomos të usuli-fikhut, që të nxjerrin një rregullore të përgjithshme të fesë, e cila në gjuhën arabe quhet '*Sed-dul Dheraie*' – 'mbyllja e shtigjeve të cilat çojnë në haram', që është shumë e rëndësishme në jetën e misionarit islam.

21- STOLISJA ME AR

Nga Adullah Ibën Abasi r.anhuma transmetohet se: *'I dërguari i Allahut xh.sh. pa një unazë ari në dorën (gishtin) e një njeriu. Muhamedi a.s. ia nxori atë prej gishtit, e hodhi (në tokë) dhe tha: A guxon dikush nga ju që ta mbajë në dorën e tij një gacë nga zjarri i xhehenemit? Pastaj (të tjerët) i thanë atij njeriu: Merre unazën (dhe shite apo bëj diçka tjetër). Ai iu tha: Vallahi jo, nuk e marr atë unazë të cilën e hodhi Muhamedi a.s.'* [Transmetim i Imam Muslimit].

Hadithi i lartpërmendur është një prej shumë haditheve të vërteta të cilat tregojnë se stolisja me ar është haram për burrin. Edhe pse hadithi në fjalë ka të bëjë me të barturit e unazës (stolisjen e gishtit me ar), kjo nuk do të thotë kurrsesi se bartja e zinxhirit apo hallkave prej ari, etj. janë të lejuara. Dallimi në vendin e bartjes nuk merret fare në konsiderim. Sa i përket femrës, pjesa dërmuese e dijetarëve, dhe mes tyre edhe imamët e katër medhhebeve, mendojnë se stolisja me ar është e lejuar, nëse ajo nuk e tejkalon URFIN e vendit - traditën e zakonshme të vendit të vet (që do të thotë se ajo nuk ka diçka më tepër nga shoqet e saj). Në këtë rast, dijetarët islamë ndahen në disa mendime.

Imam Termidhiu dhe Nesaiu transmetojnë se Muhamedi a.s. ka thënë: *"Ari dhe mëndafshi janë të lejuara për femrat e umetit tim dhe janë të ndaluara për meshkujt"*.

Termidhiu ka thënë se hadithi është i mirë dhe i vërtetë.

Me këtë rast nuk kemi për qëllim që t'i diskutojmë argumentet fetare përkitazi me temën, por na intereson të dimë shkaku dhe urtësinë e këtij ligji islam madhështor.

Për çfarë arsye është ndaluar ari për burrat dhe nuk është ndaluar ndonjë stoli tjetër, që mund të jetë akoma më e shtrenjtë?

Përgjigjja është se Allahu xh.sh. e ka bërë arin si një bazë vlere për gjërat e tjera të vlefshme, në çdo kohë dhe në çdo vend. Sado që të ndryshojnë formalisht çmimet e gjërave të tjera, është e domosdoshme që ky ndryshim të kthehet në çmimin e arit. Allahu xh.sh. e ka krijuar këtë metal të vlefshëm që njerëzit ta përdorin dhe të jetë një vlerësues i drejtë në mes pasurive të tjera. Allahu xh.sh. e ka bërë këtë metal që të jetë vetë i çmueshëm, prandaj popujt angazhohen të gjithë që ta përfitojnë këtë thesar të çmueshëm, duke e paraqitur secili në treg pasurinë e tij, në mënyrë që të lehtësohet zhvillimi i jetës në tokë. Mu për këtë arsye nuk bën që të pakësohet përdorimi i arit, sepse vështirësohet jeta e njerëzve. Me përdorimin e arit për stolisje dhe zbukurime bëhet një lloj konsumimi i tij dhe, në këtë mënyrë, jeta vështirësohet.

Një dëm dhe mëkat akoma më i madh, nga ai që u tha më lart, është kur të varfrit i shohin copat e arit dhe argjendit nëpër banesat e pasurve. Dikush prej tyre i vendos si stoli, kur në vend të tyre mund të kishte vendosur

edhe stoli prej porcelani apo diçka tjetër. Dikush prej tyre përdor edhe enë prej ari dhe argjendi. Të varfërve iu thyhen zemrat kur i shohin këto, pasi ata mundohen me mish dhe me shpirt që të sigurojnë një sasi tejet të vogël të vlerës së arit, për të siguruar kafshatën e gojës apo një jetë mesatare të tyre.

Nga kjo pikëpamje shihet dhe kuptohet se metalet e tjera të çmueshme, si: inxhitë, elmazi, platini etj., nuk janë të rrezikshme e të ndaluara si ari dhe argjendi, për arsye se këto thesare (stoli) nuk janë, në esencë, bazë për çmimet e tjera dhe përdorimi i këtyre nuk shkakton thyerjen e zemrave të të varfërve.

Imam Gazaliu, për temën në fjalë, përmend edhe ajetin kur'anor prej sures Et Teube, ku Allahu xh.sh. thotë: “...*Edhe ata të cilët konservojnë ar edhe argjend dhe nuk e japin atë në emër të Allahut xh.sh., përgëzoi ata me një dënim të dhembshëm.*” Imami ndërhyr dhe thotë: “Të gjithë ata të cilët, nga pasuria e tyre, kanë blerë enë prej ari dhe prej argjendi janë më të këqij se ata të cilët e grumbullojnë arin dhe argjendin...”

Nga ky aspekt shihet se përdorimi i arit, si për burra ashtu edhe për gra, ndalohet, mirëpo mbasi që është në natyrën e gruas që të hijeshohet që burri i saj të kënaqet, atëherë nuk ka pengesë që ajo të stoliset me një sasi ari, me qëllim që asaj t’i shtohet bukuria mbi bukuri, ndërsa për burrin përdorimi i arit nuk lejohet në asnjë aspekt.

E nëse gruaja e tejkalon kufirin e stolisjes me ar dhe dallohet nga shoqet e saj, atëherë, si për gruan ashtu edhe për burrin, përdorimi i arit është haram.

22 -ATO TË VESHURAT DHE TË ZHVESHURAT

[TË MBULUARAT DHE TË ZBULUARAT]

Nga Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë: *“Kam parë dy lloje njerëzish që janë në xhehenem përgjithmonë: Lloji i parë janë ca njerëz mbajnë në duart e veta kamxhikë si bishtat e lopëve, e me ato kamxhikë i rrahin njerëzit, dhe lloji i dytë janë disa gra të veshura, por që në fakt janë të zhveshura dhe të larguara nga rruga e fesë islame. Ato gjatë ecjes së tyre shtrembërohen djathtas dhe majtas dhe flokët e tyre iu ngjajnë gungave të deveve. Ato nuk kanë për të hyrë në xhenet dhe as nuk kanë për ta ndierë erën e xhenetit, edhe pse në të vërtetë era e tij ndihet shumë larg...”* [E ka transmetuar Imam Ahmedi dhe Muslimi, dhe ky shqiptim i hadithit është i Muslimit.]

Hadithi i lartpërmendur bën fjalë për dy lloje njerëzish të cilët janë banorë të xhehenemit në ditën e kiametit. Lloji i parë është i njohur dhe çështja e tyre është diskutuar shpesh. Ai lloj është një grup zullumqarësh me shkopinj në duart e tyre që i shtypin të tjerët. Në këtë rast ne nuk do të flasim për ta.

E ndërsa lloji tjetër janë disa gra të çuditshme të cilat Pejgamberi a.s. nuk i ka parë, mirëpo Allahu xh.sh. ia ka treguar atij nëpërmjet vahjit. Ato kanë veshur një lloj veshjeje që iu lejon atyre t’iu shihen pjesët e turpshme të trupit. Nuk mundesh të thuash se ato janë të mbuluara e të veshura, sepse mbulimi i tyre në atë mënyrë konsiderohet si shenja më e madhe që ato janë të zhveshura.

Çdonjëra prej tyre mundohet, me bukurinë e saj femërore, që t’i joshë dhe përfitojë meshkujt. Ato kanë bërë mbi kokat e tyre një lloj modeli, me flokë të mbledhura si gunga e deveve, për t’ua tërhequr vërejtjen më shumë meshkujve... Pejgamberi a.s. thotë se ato nuk kanë për të hyrë në xhenet dhe as që kanë për ta ndier erën e tij, edhe pse era e tij ndihet nga një largësi tepër e madhe.

Sa i përket mrekullisë dhe madhësisë së hadithit, në lidhje me faktin se Muhamedi a.s. ka treguar për këtë gjë që para 14 shekujve, dijetarët e mëdhenj kanë folur gjerë e gjatë, duke thënë se edhe ky hadith i Muhamedit a.s. është argument për pejgamberllëkun e tij dhe se për këto lajme, që ai ka treguar se do të paraqiten në të ardhmen, ka qenë i informuar nga Allahu xh.sh. nëpërmjet shpalljes dhe pejgamberllëkut.

Urtësia që qëndron pas së këtij kërcënimi të rëndë, nga ana e Muhamedit a.s., rreth kësaj çështjeje do të jetë tani tema jonë e diskutimit.

Shihet qartë se ajo femër apo grua, e cila del nga shtëpia kësisoj, mundohet t’i bindë në maksimum burrat, të cilët e shikojnë atë femër të zhveshur, se femra e rrugës është më e mirë dhe më e përparuar dhe se

dikush meriton të kënaqet më shumë me të, se sa me atë e cila qëndron në shtëpi.

Gjestin e gruas, e cila del në rrugë e zhveshur në këtë mënyrë për të shkaktuar sa më shumë trazira dhe për të zgjuar epshin e të rinjve apo të vjetërve, të pamartuarve apo të martuarve, dijetarët e mëdhenj të fesë islame, sociologët e njohur dhe ekspertët të cilët merren me problemet e shoqërisë, e konsiderojnë si “helm mbytës” të cilin ajo e hedh mbi meshkut për t’i shkatërruar ata.

Nëse kjo grua nuk ruhet që asaj të mos t’ia prekë dorën ndokush me qëllim që ai të kënaqet, me të vërtetë kjo grua konsiderohet si një zjarr i fortë dhe i ndezur, që i shkrin familjet, ua humb atyre shenjat dhe nuk mbetet më asgjë për t’u krenuar për nga nderi apo pozita familjare.

Si fryt i këtyre dy rasteve që u cekën më lart është ‘belaja e vazhdueshme dhe shkatërrimi katastrofal i rinisë’.

Sheriati i Allahu xh.sh. (ligji i tij) dëshiron që t’i sigurojë njeriut një jetë të ëmbël, të qetë e të kënaqshme, në të cilën shpirti i tij kënaqet sinqerisht dhe realisht duke e dëgjuar dhe praktikuar këtë ‘KANUN’ (ligj) të Allahut xh.sh. i cili thotë: *“O ti pejgamber, thuaju grave të tua, vajzave të tua dhe grave të besimtarëve që të mbulohen me xhilibabe (mantele) të gjata e të gjera prej majës së kokës e deri në fund të këmbëve, e me këtë mbulesë dihet më mirë që ato nuk janë rrugaçe dhe iu ruhen ofendimeve, se me të vërtetë Allahu xh.sh. është falës dhe i mëshirshëm.”* [El Ahzab: 59]

Mu për këtë arsye, gruaja apo vajza e cila largohet nga ky ligj i Allahut xh.sh. dhe del dhe e sfidon shoqërinë me bukurinë dhe stolinë e saj, me këtë vepër të shëmtuar ajo e përgatit veten e saj për një zjarr tejet të rreptë e të ashpër, lëndët djegëse të të cilit janë njerëzit dhe gurët. Mbi këtë zjarr sundojnë disa melekë të ashpër dhe të fortë, të cilët nuk e kundërshtojnë Allahun xh.sh. për asgjë dhe veprojnë menjëherë ata çka urdhërohen.

Prandaj, oj motër muslimane, nëse je besimtare ndaj këtij ligji të Allahut xh.sh., i cili i obligon njerëzit besimtarë që të punojnë sipas tij dhe nëse je besimtare e këtij Pejgamberi, i cili ka paralajmëruar se ky lloj i grave nuk do të hyjë në xhenet e as që do ta ndiejë erën e tij, atëherë të kesh kujdes dhe frikësoju Allahut xh.sh. me këtë kundërshtim tëndin ndaj ligjit të Tij dhe mos të të mashtrojë bukuria jote dhe epshi yt i çoroditur që të futesh në shkatërrim, për të cilin do të pendohesh shpejt, por atëherë nuk do të ketë efekt pendimi. Bukuria jote do të zhduket shpejt e si pasojë do të të mbetet vetëm një gjë: një zinxhir i rëndë me të cilin do të të tërheqin ditën e gjykimit në zjarrin e xhehenemit. Po ta tërheq vërejtjen që mos ta hidhërosh Allahun xh.sh., Krijuesin e gjithësisë, Krijuesin e xhenetit dhe xhehenemit, për të ngopur një epsh që është një kënaqësi e shkurtër e kësaj jete. Ta tërheq vërejtjen që mos të bëhesh ti shkaktare, me trupin tënd të zhveshur, që meshkujt ta prishin moralin dhe të largohen nga

rruga e drejtë e të bien në humnerë, e ti nesër në ditën e gjykimit do të ngarkohesh me mëkatet e atyre të cilët kanë qenë në rrugën e Allahut xh.sh. dhe kanë vepruar sipas fjalëve të Muhamedit a.s., e ti je bërë shkaktare që ata të devijojnë nga kjo rrugë e drejtë.

Të kesh kujdes e të mos shndërrohesh në një armë shkatërruese që të shkatërrosh rininë, e mos ja plotëso dëshirën e armikut, i cili nëpërmjet teje dhe trupit tënd të zbuluar mundohet ta prishë rininë islame...

Të kesh kujdes që të mos mashtrohesh mbas reklamave, parullave dhe gënjeshtreve që thonë se grua apo vajzë e përparuar është ajo që del e zhveshur para masës në teatër duke lozur...

Kjo është rrenë, vallahi! Mos iu besoni atyre të cilëve ua thonë këto fjalë. Nëse kërkon argumente për këtë, shih gjendjen aktuale dhe do të shohësh se vajza me mbulesë islame martohet, rehatohet dhe e gjen follenë e saj më shpejt, ndërsa ajo e zbuluara mbetet e humbur dhe askush nuk kujdeset për të...

Normal këto fjalë ndikojnë te ti, oj motër, nëse je ti besimtare ndaj ligjit të Allahut xh.sh., i cili i obligon gratë dhe vajzat që të mbulohen me mbulesë islame.

E nëse ti, oj motër, nuk beson atëherë unë si një vëlla musliman, i cili dëshiron të mirën tënde, të këshilloj sinqerisht që të shpejtosh e të hulumtosh sa më shpejt që ta gjesh të vërtetën dhe ta kuptosh se ti je e humbur, se ty të kanë mashtruar dhe t'i kanë ngatërruar çështjet ...

Shpejto, oj motër, që ta gjesh të vërtetën, për të cilën ty të kanë mashtruar, para se të të vijë vdekja, pasi atëherë është vonë për ty. Shpejto para se të të vijë exheli e ti të mbetesh e habitur se sa shpejt të kaloi jeta. Shpejto dhe kthehu në rrugën e Allahu xh.sh sa më shpejt!

Allahu të ndihmoftë! Amin!